



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 16.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.7.2008 ‘Për taksat kombëtare’ të ndryshuar”
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”
4. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Reme Lala, Eljo Hysko.

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Zv/Minister Z. Elton Haxhi,
2. Z. Niko Lera, Drejtor I Pergjithshem,
3. Z. Enkeleda Pipa, Drejtor I Politikave Fiskale

4. Z. Enkeleda Kuci, Pergjegjes Sektori Politikave
5. Z. Dorian Toro, Specialist

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtoresh e Pergjithshme,
2. Znj. Ilda Koja, Drejtor Juridik
3. Z. Klodi Plloca, Drejtr IT

Arben Ahmetaj – Jepiani dosjen e ligjeve zotit Angjeli!

Fillojmë me procedurat tatimore.

Projektligji për faturën u shqyrtua nen për nen.

Sot kemi shqyrtimin e projektligjeve për procedurat, taksat kombëtare, tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

Kemi prezent zëvendësministrin, zotin Elton Haxhi, zotin Niko Lera dhe zonjën Delina Ibrahimaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më intereson.

Zoti Angjeli, fjala për ju!

Anastas Angjeli – Për nenin 1...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Procedurat tatimore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kur të flasim për atë nen, do ta marrësh fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – 9920.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kaluam.

Arben Ahmetaj – E kaluam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kaluam edhe në tërësi. A nuk ishte këtu kur u votua? Kur të bëhesh deputet, duhet ta dish këtë. Do të bëhesh një ditë, me sa po shikoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndiq procedurën!

Anastas Angjeli – Ke perspektivë.

Për nenin 1 nuk kemi vërejtje.

Keni vërejtje?

Arben Ahmetaj – Nëse nuk ka vërejtje për nenin 1, kush është pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Me votën kundër të zotit Roshi, miratohet neni 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem.

Anastas Angjeli – Në nenin 2 ka disa korrigjime, që vijnë për efekt të procedurës legjislative, kështu që pikën 2, por edhe në të gjithë tekstin e ligjit, kudo që janë vendosur dhe përdorur referenca nga legjislacioni aktual në fuqi, të tilla si: “Ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit, qarkullimit apo për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, për teknikë legjislative është mirë të kemi një zëvendësim me përcaktimin “Legjislacioni në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Këto janë procedura legjislative, nuk prishin punë dhe nuk krijojnë asnjë shqetësim.

Arben Ahmetaj – Jeni duke folur për nenin 1 apo jo, zoti Angjeli?

Anastas Angjeli – Për nenin 2.

Arben Ahmetaj – Më falni, për nenin 2.

Anastas Angjeli – Gjithashtu, në të gjithë tekstin e ligjit, përfshirë edhe këtu, kudo që është përdorur përcaktimi “ministër i Financave”, siç vepruam edhe në ligjin e mëparshëm, do të procedojmë me togfjalëshin “ministri përgjegjës për Financat”. Jeni dakord?

Arben Ahmetaj – Te neni 1?

Anastas Angjeli – Te neni 2.

Arben Ahmetaj – Më falni, te neni 2.

Vazhdoni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Shikojeni mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jemi te procedurat tatimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Vullnet, keni amendim, apo jo?

Nuk keni propozim, zoti Vullnet?

Vullnet Sinaj – Jo.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Anastas Angjeli – Neni 3 do të jetë sipas propozimit që ka bërë qeveria. Jeni dakord?

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 4 do të jetë sipas propozimit të projektit të paraqitur.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli - Neni 5 është një nen shfuqizues për disa nene që ka sjellë qeveria dhe i propozon.

Jemi dakord.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 6 do të ngelet siç ishte, vetëm ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Angjeli, janë kushte të lidhura me ligjin e fiskalizimit, që e kaluam më parë.

Anastas Angjeli – E thashë në fillim që një pjesë e ndryshimeve janë edhe burim i harmonizimit midis paketës dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fiskalizimin, kusht që e vendosëm në fillim të diskutimit.

Neni 6 ngelet siç ishte.

Keni sugjerime?

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Në nenin 7 mendojmë se nuk ka asnjë arsye të ritheksohen fjalët “penalizohesh në disa dispozita”, kur diçka e tillë përcaktohet me detaje në dispozitat për penalitetin, sepse duket sikur e bëjmë vetëm ligj penalizimesh.

Arben Ahmetaj – E saktë.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, nëse doni të bëni muhabet me njëri-tjetrin, mund të bëjmë 5 minuta pushim, që ju të pini një kafe dhe të vini sërish.

Anastas Angjeli – Kjo bie.

Jeni dakord?

Arben Ahmetaj – Ju lutem, vëmendje!

Sipas zotit Angjeli, bie pjesa ku përsëritet penalizimi.

Anastas Angjeli – Jemi pro.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 8, zoti Angjeli.

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Të mos e bëjmë këtë ndryshim, sepse e bëmë aty.

Neni 8 do të ngelet siç ishte, pasi e bëmë ...

Arben Ahmetaj – Duhet ritheksuar.

Zoti Angjeli, kërkoj ndjesë që ndërhyj, por dëgjoni se çfarë thuhet!

“Deklarata e ndryshuar për tatimpaguesit mund të ndryshohet brenda 36 muajve vetëm 1 herë nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare, me kushtin që kjo deklaratë të mos jetë kontrolluar më parë...”.

Anastas Angjeli - ... “dhe pas deklarimit nga e nesërmja e datës së deklarimit”.

Arben Ahmetaj – Mund t’i pyesim pse e kanë vënë kështu?

Anastas Angjeli – Nuk e kanë ata, e kemi ne.

Arben Ahmetaj – Pse e kanë vënë këta kështu?

Anastas Angjeli – Pse e kanë vënë pas deklarimit?

Arben Ahmetaj – Pse e kanë vënë kështu?

Keni ndonjë argument pse e keni vënë kështu?

Anastas Angjeli – Shikoni nenin 8!

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pra, thuhet “Vetëm një herë nga afati i dorëzimit të deklaratës, me kushtin që kjo deklaratë të mos jetë kontrolluar më parë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Në pikën 2 të nenit 8 thuhet: “Deklarata e ndryshuar ...”, e të tjera. Je dakord?

Arben Ahmetaj – Po.

Anastas Angjeli – Në paragrafin e tretë të pikës 2 thuhet: “pas deklarimit” dhe ne kemi sugjeruar të zëvendësohet me fjalët “nga e nesërmja e datës së deklarimit”.

Zotit Ahmetaj po pyet pse e keni vënë “pas deklarimit”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pse duhet “deklarim”? Ne e kemi këtë. Pse e ndryshoni? Pse e ndryshoni paragrafin e parë? Cila është arsyeja?

Anastas Angjeli – Nuk e ndryshojnë ata.

(Mungesë incizimi)

Arben Ahmetaj – Më falni, ju që keni në dorë të gjithë Shqipërinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja deputete, nuk ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta ndryshojnë sa herë të duan brenda kësaj ...

Mos e tund kokën, djalë!

Unë kam qenë atje ku je ti dhe e kam kërkuar këtë.

Ta ndryshojnë sa herë të duan në bazë të vetëdeklarimit. Çfarë do të thotë kjo? A është vetëdeklarimi? Ka dy parime fisku. Ti dhe unë i kemi mësuar kur kemi lindur në atë punë: e para, të jetë *fair*, e dyta, të jetë vetëdeklarues.

Pse ia heq të drejtën? Ndërkohë që pendohet se ka bërë gabim dhe e vetëdeklaroi atë që ka fshehur, largqoftë, apo ka bërë gabim dhe e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë problemi keni ju me këtë?

Niko Lera – E drejta për ndryshim automatik, jo një herë, por disa herë, dhe këtë e ka evidentuar administrata tatimore, duke krijuar precedentë të fshehjes dhe të manipulimit të detyrimeve tatimore.

Arben Ahmetaj – Niko, ti je njeri që nuk thua gjëra që nuk qëndrojnë, por kjo që thua nuk qëndron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zonja, do të vijmë edhe aty.

Nuk do të ikim pa folur ato që duhet të themi, por kjo është thelbësore.

Çfarë do të thotë “e fshehin”? Ku është diferenca nëse ti i jep të drejtën e vetëdeklarimit, që e ka universale në genetikën e formatit fiskal?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doje të shtypje mikrofonin dhe ngrite dorën. Duro!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duro!

Vetëdeklarimin e ka fituar si të drejtë brenda legjislacionit. Ti do t’ia kufizosh vetëm një herë brenda 36 muajve? Unë nuk e kuptoj këtë arsye. E gjithë historia është të kemi biznese që vetëdeklarohen dhe të rrisin deklarimin vazhdimisht. Ti më thua se në sistemin automatik

... Çfarë problemi ka në sistemin automatik? Të bëjmë ushtrimin dhe të themi se unë si tatimpagues fsheha ose bëra gabim. Pas 3 muajve vendos ta korrigjoj. Pas 3 muajve të tjerë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida, do të flasim, por më falni, pasi po diskutojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të më ndihmosh, sepse unë kam gjithmonë nevojë për ndihmë, por të bëjmë debat për të kuptuar logjikën e administratës.

Niko Lera – Ne, zoti kryetar, nuk ia heqim të drejtën që ai të ndryshojë deklaratën fillestare për herë të dytë, të tretë e më shumë, por i themi që për herë të parë, të mos lërë kosto administrative, të ndryshoje në mënyrë automatike, por nëse këtë e ke ndryshuar me vullnetin dhe bindjen tënde dhe t’u ndërrua mendja dhe do ta ndryshosh sërish, hajde në administratë, thuaju se do ta ndryshosh këtë dhe ...

Arben Ahmetaj – Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ndërhyjni!

Ju lutem, dua vetëm të më ndihmoni, siç do të më ndihmojë Senida!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Prisni, të vëmë pikën mbi I!

Pse e ndryshon buxhetin e shtetit disa herë nga buxheti fillestar? Sepse ka dinamikë.

E dyta, çfarë do të thotë “deklaratë fillestare”? Deklarata që unë kam korrigjuar kthehet deklaratë ligjore. Kam deklaratën fillestare? Vij me deklaratën korrigjuar. Kjo u rrëzua, është ligjore. Vjen deklarata tjetër dhe nëse ti kërkon të më thërrasësh mua, prandaj të ka investuar Republika e Shqipërisë, tatimpaguesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, Turi!

16 milionë euro janë shpenzuar për sistemin që kanë ndërtuar austriakët dhe pothuajse e njëjta shumë me fiskalizimin që ti nga zyra ... Dhe thua: “të vijë në administratë”. Pse, ngenë tënden dhe timen ka ai të vijë tek ty në administratë sa herë që ka nevojë të korrigjohet? Jo, ta thërrasësh ti nga zyra, ti thuash: “Zoti Niko, tatimpaguesi me niptin xxx, ka probleme.

Mund ta diskutojmë bashkë virtualisht, sepse kemi ndërtuar gati 35 milionë euro sistem? Mund ta diskutojmë? Mund të ndihmoj”? Jo, kjo nuk kufizohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Niko, nuk ta dhashë lejen e fjalës.

Zonja Senida, mund të më ndihmosh, të lutem?

Senida Mesi –Në rastin konkret, nëse administrata tatimore e konsideron me risk ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Niko, më dëgjoni, ju lutem!

Nëse ju e konsideroni dhe keni informacione të mjaftueshme për ta konsideruar një tatimpagues, nëse e ndërron një deklaratë 3, 4, 5 herë brenda 12 muajve, keni klasifikimin e riskut dhe ti ndryshon klasifikimin e riskut të atij subjekti nga niveli 1-niveli 5, shkon vetë ose komunikon në mënyrë virtuale, siç tha kryetari, me *e-mail* apo telefon, dhe bën një kontroll, verifikim, konfirmim, quaje si të duash, por jo për hir të komoditetit të stafit të administratës së tatimeve, ne të mendojmë si ta bëj unë punën më mirë që ai të mos më mashtrojë mua? Po ia nxij jetën dhe pasi t’i nxij jetën t’i them: A vjen pak tek unë? E dini si është kjo? Sikur unë t’i them: Hajde tek unë, sepse po pate ti nevojë, të rregulloj unë diçka dhe rris nivelin e abuzimit e i lë hapësirë korrupsionit të vogël apo të madh (nuk e di sa do të jetë), që tatimpaguesit të shkojnë te zyra e tatimeve.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Senida Mesi – Të lutem, klasifiko riskun! Nëse ti e konsideron me risk të lartë, klasifikoje me risk të lartë, përfshije në kontroll fizik, në kontroll me verifikim, më shpesh sesa një tatimpagues tjetër për të minimizuar riskun! Kaq.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Niko, nuk ju është dhënë leja të flisni.

Faleminderit, zonja Senida!

Propozoj që neni 8 të bjerë i gjithi.

Ç’mendim keni ju, zoti Angjeli?

Anastas Angjeli – Të bjerë neni 8 i projektit që...

Arben Ahmetaj – Po, neni 8 i projektit.

Anastas Angjeli – Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Patjetër! Zonja Blerina, votohet edhe me votat e opozitës.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Neni 9 mbetet siç është. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, të mos e bëjmë pazar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

8-a iku.

Arben Ahmetaj – Neni 9 bëhet neni 8, gjithsesi.

Anastas Angjeli – Ato i rregullojnë këta. Mos u merrni me numra!

Arben Ahmetaj – I rregullon shërbimi, por ta kemi për rekorde.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mos bëni punë kot, Niko! Mos e harxhoni kohën kot ndonjëherë atje!

Anastas Angjeli – Neni 10 mbetet siç është propozuar nga qeveria. A ka ndonjë vërejtje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem! Për nenin 10?

Anastas Angjeli – Na e thuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

– Te neni 10, me këtë shprehjen “në raste të veçanta”, çfarë nënkuptojmë? Sepse këtu mund të lihet goxha hapësirë për abuzim. Kur do të aplikohet dhe kur nuk do të aplikohet? Cilët tatimpagues...? Çfarë parashikohet me “raste të veçanta”? Ose duhet ta heqim, ose duhet ta specifikojmë.

Arben Ahmetaj – Ka të drejtë deputetja! Rastet e veçanta kthehen në raste të përgjithshme ose hiqen fare. Prandaj, administrata dhe ministria duhet të jenë më të qarta. Keni shumë të drejtë, zonjë!

“Në raste të veçanta shuma e tatimeve dhe taksave për t’u paguar apo të paguara më tepër...” Pse në rastet e veçanta? Cilat janë rastet e veçanta?

Niko Lera – Ne kemi pasur një problem me tatimpagues të caktuar, që janë debitorë për administratën tatimore dhe janë kreditorë për administratën doganore. Po marrim si shembull Bankers-in. Ka shuma të mëdha për të marrë. Ka shuma të mëdha për të paguar. Legjislacioni ekzistues nuk na lejonte të bënim edhe kompensime të tilla dhe menduam të kemi një hapësirë ligjore, në mënyrë që për të lehtësuar, sikurse e thatë edhe ju, jetën e tatimpaguesve, të kemi mundësi të bëjmë edhe kompensime të tilla pa kaluar në mekanizma të tjerë.

Arben Ahmetaj – A mund t’ju bëj një pyetje? Hapët një diskutim shumë interesant.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë e rëndësishme kjo. Ju falënderoj sërish!

(Diskutime pa mikrofon)

Senida, mos u mërzit, se do të vijmë aty.

Niko do të bëjë prapë shpjegim për nenin 11.

Anastas Angjeli – Aktualisht jemi te neni 10.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje?

Anastas Angjeli – Ka një sugjerim nga deputetja. Kush është dakord me sugjerimin e saj?

Arben Ahmetaj – Më fal, ta diskutojmë, se ndoshta administrata...!

T’ju bëj një pyetje? Pra, ju do të lejoni edhe TVSH-në të kompensohet, apo jo? Se kemi edhe një specialiste të TVSH-së këtu.

Si ka mundësi që mund të lejohet TVSH-ja brenda vetes të kompensohet me taksa të tjera? Ku e keni parë këtë?! TVSH-ja ka sistem kreditimi brenda vetes deri në rimbursim. Si mund të merrni...? Çfarë do të thotë kjo?! Do të korrigjoni edhe kredinë, edhe detyrimet? Çfarë do të thotë kjo histori?! Si mundet...?!

Niko Lera - Ne flasim nëse ka një detyrim të maturuar. Pra, nëse unë kam një rimbursim të miratuar për x kompani...

Arben Ahmetaj – Po në qoftë se ke tatimfitim, çfarë do të bësh? Do të ma kompensosh me detyrimet këtej?

Nikolla Lera - Patjetër.

Arben Ahmetaj – Me TVSH-në?

Nikolla Lera – Ndodhin edhe sot. Në qoftë se unë kam një kërkesë rimbursimi 10 milionë, që administrata...

Arben Ahmetaj – Mos kap këtë element!

Nikolla Lera - Po cilin të kap?

Arben Ahmetaj – E kundërta, ndryshe. E ke tek tatimfitimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të dyja, le të themi.

Nikolla Lera – Kompensohet.

Arben Ahmetaj – Si i kompensuaka?! Çfarë ndodh me TVSH-në? TVSH-ja shtrembërohet në zinxhir, kur ti i ul ose i ngre.

Si më the, Enkelejda?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse nuk e thua këtu? Kjo do të thotë se e keni gabim që e përcaktoni në ligjin e procedurave. Ja, ku po e thoni vetë gabimin! Ku e shkruan këtu? Pastaj ti shkoj unë Hasanit dhe Hysenit tek tatimet, që të bëjnë si të duan? Ku e ke të rimbursuar këtu? Pse bëni nga këto gjëra?! Se po bëj tani sikur po hapim debat.

Bie, keni shumë të drejtë, zonjë! Futeni te ligji i TVSH-së, përcaktojeni qartë se si bëhet. Kur është e rimbursueshme... Ku e keni këtu?

Deputetët ju besojnë ju në profesionalizëm.

Anastas Angjeli – Aq më tepër që ja ka lënë ministrit të financave që ta bëj me udhëzim.

Arben Ahmetaj – Ju vini e i fusni një “në raste të veçanta”, pastaj ministri i Financave do të kompensojë taksa dhe i fusni edhe kushtetutshmëri problematikës! Jo! Përcaktojeni mirë!

Jo, Niko, jo, përcaktojeni mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk përcaktohet në udhëzim kjo që marrke ti nga ato që janë të rimbursuara... Si e bëke ti këtë?! Ajo që është e rimbursueshme, nuk është më detyrim, as pagesë e tepërt. Ai është detyrimi yt ndaj sipërmarrjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ku e ke?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko, mos fol pa leje!

“Në rastet e veçanta shuma e tatimeve dhe taksave për t’u paguar apo të paguara më tepër në administratën tatimore, mund të kompensohet me tatime dhe taksa të paguara më tepër apo për të paguar në administratën doganore.” Nuk e ke rimbursimin këtu. Rimbursimi nuk preket, se rimbursimi është detyrimi yt ndaj sipërmarrjes. Ku e ke këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Do ta bësh me udhëzim ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të na falësh që nuk po arrijmë të të kuptojmë Niko, por keni avancuar ju, që kur nuk jemi mbledhur ne!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Nuk po e shprehim saktë atë...Aktualisht, ne e kemi të drejtën e kompensimit të debive dhe kredive brenda administratës tatimore. Pra, aktualisht, nëse ti ke

një detyrim në TVSH dhe ke një kredi tatimfitimi, mund të kompensohesh. Nëse ke një pagesë të tepërt, një tatim tjetër dhe një...

Arben Ahmetaj – Anasjelltas me TVSH-në nuk ma the.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse më ikën nga kjo? Se këtu fute TVSH-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mirë, çfarë problemi ke atëherë?

E keni? Faleminderit! Nuk keni nevojë ta sillni.

(Zoti Nikolla Lera flet pa mikrofon)

Nikolla Lera – ...nëse për Bankers-in ne këtë sot e bëjmë brenda detyrimeve tatimore, prapë Bankers-i sot ka kërkesa për rimbursim, sepse...*(nuk dëgjohet)* dhe ai nuk paguhet për rimbursim, por një detyrim tatimfitimi që ka e kompenson te...

Arben Ahmetaj – Është e gabuar në teknikë fiskale. Rimbursimi duhet të jetë rimbursim definitiv, i dallueshëm në llogaritë e shtetit. Rimbursimi është thelbi i TVSH-së. Ti nuk mund të marrësh një detyrim... Pra, çfarë bën ti? Nga TVSH-ja bruto ti nuk prek rimbursimin e detyrueshëm dhe pastaj deformon tatimfitimin. Jo, more, Niko! Mos e tund kokën ashtu!

Çfarë do të thotë kjo? Pra, ti ke për të rimbursuar 100 milionë lekë Bankers-it dhe ndërkohë Bankers-i të ka ty 100 milionë lekë në anën tjetër dhe ti i thua se nuk po ta rimbursoj dhe nuk po të marr nga tatimfitimi! Po brenda logjikës së rimbursimit, që mua nuk m'u dallua rimbursimi, çfarë ndodh?

Nikolla Lera – Këtë shumë ne e pasqyrojmë të rimbursueshme. Atë 100-milionëshin që thoni ju...

Arben Ahmetaj – Më fal, një sekondë! Meqë po fillojmë te “a”-ja e fiskut, në qoftë se ti ma bëke këtë lëvizje kontabël, pse nuk ma bën lëvizjen kontabël direkt? Ia rimburson në llogarinë e tij dhe direkt ia merr, se e ka detyrim. Çfarë problemi ka t’ia bësh këtë? Kush të pengon?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ke nevojë, se ta jep ligji të drejtën ta bësh automatikisht. Nuk është e vërtetë që ti ke nevojë të thërrasësh subjektin. Ti i bën rimbursimin në llogari automatikisht, se ti veprimin kontabël do ta ësh në kontabilitet.

Naçi, më fal, se e kthjem në...!

Anastas Angjeli – Këta tani po bëjnë debat për një ligj që e kanë bërë për një subjekt. Ne nuk bëjmë ligje për një subjekt. Ne bëjmë ligje për të gjithë tatimpaguesit. Ju keni bërë tri nene...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Niko, keni bërë tri nene vetëm për Bankers-in! Të lutem shumë, ne nuk bëjmë ligje këtu as pro, as kundër një subjekti! E lëmë këtë muhabet! Ta rrezojmë!

Arben Ahmetaj - Çfarë propozimi keni, zoti Angjeli?

Anastas Angjeli – Propozim dhe mbaron ajo histori! Kemi një orë debat për një subjekt! Çfarë është kjo histori?!

Arben Ahmetaj – Kush është pro propozimit të zotit Angjeli?

Nuk ka nevojë. Ta rrezojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Po lëre tani! E ke edhe te neni 11. E ke vënë edhe me datë, madje! Lëreni tani, mos na mërzitni! Mbaj shënim ato që themi, reflekto dhe mbaroni punë!

Arben Ahmetaj – Mos më sillni më në këtë komision të nderuar nga këto “të shkruesit, të shkruesit, të shkruesit...”! Këtë e kam shumë seriozisht! Jemi edhe në media dhe më vjen zor që e them këtë.

Nuk të takon ty, Niko, pas 30 vjetësh, të më sjellësh nga këto. Ti e di shumë mirë se si bëhen në kontabilitet. Ti na ka mësuar edhe ne. Tani më sjell mua nga këto budallallëqe këtu!

Anastas Angjeli - Jemi te neni 11.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iku ajo.

Te neni 11, Niko, mbaje shënim, ne kemi bërë një formulim që të jetë i hapur neni. Në qoftë se keni ndonjë detaj, na e thoni, por nuk vëmë data e gjëra, që të nënkuptohen.

Prandaj, duke pasur këtë logjikë, neni riformulohet: “Përfundimisht përcaktimeve të pikës 1 dhe 1/1 të këtij neni, në raste të veçanta, me kërkesë të administratës tatimore, me dakordësinë e tatimpaguesit, mund të lihet një marrëveshje për pagesë me këste, e cila përmban një plan të skeduar pagesash për detyrime që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve si rezultat i kërkesës së miratuar për rimbursimin e TVSH-së. Në këto raste detyrimi i administratës tatimore ndaj tatimpaguesit konsiderohet i shlyer dhe nuk aplikohen kamatëvonesat. Rastet kur do të aplikohet procedura dhe kriteret për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Afërisht e keni kështu. Kemi rregulluar pjesën për të qenë neni i hapur.

Kush është dakord me propozimin?

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Rregullohet numri i nenit.

Anastas Angjeli - Neni 13 ka vetëm një ndryshim të teknikës legislative.

Arben Ahmetaj – Neni 12 apo neni 13? Të më falësh!

Anastas Angjeli – Unë do të vazhdoj me këtë numër. Këta e rregullojnë me numrin rendor.

Arben Ahmetaj – E kam fjalën që kemi edhe 12-n. Duhet ta votojmë. Prandaj...

Anastas Angjeli – E votuam. Ti e hodhe në votim.

Arben Ahmetaj – Votuam nenin 11.

Anastas Angjeli – Neni 12 ngelet siç është.

Arben Ahmetaj – Duhet ta votojmë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni12.

Anastas Angjeli – Neni 13.

Siç e thashë, neni 13 ka vetëm një rregullim, që është i karakterit legjislativ. Pra, fjalët “bëhen këto ndryshime” duhen hequr si të panevojshme.

Arben Ahmetaj – Shumë mirë. Në rregull.

Anastas Angjeli – Dua vëmendjen e të gjithëve për nenin 14.

Arben Ahmetaj – Ja, të votojmë nenin 13, zoti Angjeli. Më falni!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 13.

Kalojmë te neni 14. Fokus!

Anastas Angjeli – Dua vëmendjen e të gjithëve, për arsye se, kur e diskutuam, e kemi përmendur që në diskutimin në parim, ka pasur një sugjerim dhe një vërejtje për ndryshimet që bëhen në nenin 81 për pikën 1 dhe pikën 2. Vetë zoti Arben dhe një deputet tjetër kanë bërë një sugjerim, sepse nuk ishin dakord në parim që nga numri 30 të bëhet 10 dhe në pikën 2 nga numri 10 të bëhet 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – A mund ta argumentojë zoti Angjeli, me lejen tuaj?

Anastas Angjeli - Pastaj për këtë nen ka edhe disa ndryshime të tjera, të cilat do t’jua them më poshtë, por neve na takon ta vendosim nëse do ta lëmë kështu apo do ta ngushtojmë.

Arben Ahmetaj – Çfarë arsyeje keni që njoftimin paraprak për auditim të thellë doni ta çoni nga 30 në 10? Kë doni të kapni gafil ju? A ka logjikë që tatimet të kapin gafil tatimpaguesit?! Po pse, polici jemi ne këtu?! Çfarë do të thotë?!

Po kontrollin e thjeshtë nga 10 në 5? Kë do të kapni gafil ju? Çfarë argumentimi...?

Niko, mos bëj sikur po flet me Enkelejdën! Më jep përgjigje! Çfarë argumentimi keni, që e keni bërë nga 30 në 10?

Anastas Angjeli – Të mbeten siç ishin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk dua ta vazhdojmë. I propozoj komisionit të mbetet siç ishte. Kush është dakord me propozimin tim? Faleminderit, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po, edhe 2-shi bie.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Vazhdojmë! Përveç këtyre, në pikën 8...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Gjithashtu, brenda këtij neni, pika 8 nuk përcakton drejt se kush është presoni përgjegjës. Duke qenë se gjatë gjithë kohës i jemi referuar se duhet të jetë ministri përgjegjës për Financat ose përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, të rregullohet dhe të zëvendësohet me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

Jeni dakord?

Është teknikë legjislative, nuk mund ta lësh pa përgjegjës.

Në pikën 9 kemi dy pika; germën “a” dhe germën “b”, të cilat i kemi riformuluar me qëllim që të jenë më të sakta:

a) zyrtari i administratës tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, sipas legjislacionit në fuqi, konstaton kryerjen e një vepre penale në fushën tatimore;

b) kontrolli tatimor ka filluar mbi bazën e informacionit nga strukturat kompetente sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Njoftimi paraprak i tatimpaguesit do të rrezikonte qëllimin e kontrollit tatimor. Në këtë rast kontrolli tatimor fillon menjëherë. Ka vërejtje?

Arben Ahmetaj – Nëse më lejon, zoti Angjeli, a mund të bëj një pyetje?

Anastas Angjeli – Po.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Koha e njoftimit për kontrollin e lëshimit të faturave është një ditë, dy ditë, një orë, një minutë, një sekondë, tri ditë, një javë? Apo kur i shkon te dera i thotë të njoftova?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, dua përgjigje.

Anastas Angjeli – Duhet ta vendosim gjëkund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jo, Niko është yll bote, por është në stres, sepse po mbyllet viti. Nëse do të ishte fillimi i vitit, do ta shikoje Nikon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Lera - Në paragrafin shtatë thuhet: “Njoftimi i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave i dërgohet tatimpaguesit në të njëjtën ditë kur fillon kontrolli tatimor në vendndodhjen e biznesit tatimpagues”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pra, për 30 ditë ose për 10 ditë, sepse të tjerat ranë?

Anastas Angjeli – Afati, pra.

Arben Ahmetaj – Pra, për 30 ditë dhe për 7 ditë. Jo kur fillon, sepse kontrolli fillon për 10 ditë ose për 30 ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thelluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa ditë, po të pyes?

Pra, njoftimi i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave.... Pra, paska një kontroll specifik, thua se nuk keni sistem. Dakord, do të shkoni në terren. Sa ditë, sa orë, sa minuta, është i beftë, është i paparalajmëruar, është çfarë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, kur në të njëjtën ditë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, ju lutem, një sekondë, sepse është e rëndësishme. Me përjashtim të pikave ..., njoftimi i kontrollit tatimor i lëshimit të faturave nuk është i nevojshëm t’i dërgohet tatimpaguesit përpara fillimit të kontrollit tatimor. Pra, ti shkon befasisht për ta kontrolluar nëse ka lëshuar faturë apo jo. Do të thotë që do të kufizohet vetëm te kontrolli i faturës, asgjë tjetër. Ti i shkon për kontroll të faturës, siç e ke zakon, jo ti si Niko, sepse ti je për politikën fiskale, dhe përfundon për TVSH-në brenda ditës. Jo, ajo është procedurë e shkelur. Do të shkohet vetëm për kontrollin e lëshimit të faturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

Elton Haxhi - Është edhe për punonjësit.

Arben Ahmetaj – Ku hyjnë punonjësit këtu?

Elton Haxhi – Duhet të jetë diku tjetër.

Arben Ahmetaj – Keni marrë inspektoratin ju, kontributet?

Elton Haxhi – Jo, jo.

Arben Ahmetaj - Ju i kontrolloni kontributet. Atje bëni edhe kontroll të befasishëm.

Apo nuk është kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse e fusni këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, mbase na duhet, por duhet ta argumentoni.

Zoti Angjeli, me lejen tuaj si referues, kufizohet vetëm te kontrolli i faturës dhe nuk hapet te kontrollet e tjera. Tatimpaguesit e Republikës së Shqipërisë kanë nevojë që ju të jeni procedural. Të njoftohen 10 ditë përpara për kontrollin e parë dhe për auditin e thelluar 30 ditë përpara. Nuk mund t’u shkoni në befasi sa herë të doni për t’i kontrolluar faturat dhe nga faturat të përfundoni tek TVSH-ja. Kjo është shumë e rëndësishme për anën procedurale.

Anastas Angjeli – Gjithashtu, në funksion të kësaj, në pikën 10 është bërë një rregullim i teknikës legjislative, që duhet të vendosë në rastet e përcaktuara në pikën 9 të këtij neni.

Votojmë nenin 14 me ndryshimet që bëmë.

Arben Ahmetaj – Me ndryshimet që theksuam, apo jo zoti Angjeli?

Anastas Angjeli - Që nga pika e parë me ndryshimin e afateve.

Arben Ahmetaj – Zoti Niko, të lutem rakordojuni me shërbimet e Kuvendit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet. Ra dakord edhe opozita.

Anastas Angjeli – Kalojmë te neni 15 i projektligjit.

Edhe në nenin 15, i cili ka katër pika, 7, 8, 9, 10, kemi bërë disa ndryshime, si më poshtë:

Në fund të pikës 8 të shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Një kopje e raportit të kontrollit t’i dërgohet me postë tatimpaguesit”;

shtimi i një pike të re nr. 9 ku të përcaktohet e drejta për ankimim. Një riformulim i mundshëm do të ishte: “tatimpaguesi ka të drejtë t’i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor

brenda 15 ditëve kalendarike, duke filluar nga e nesërmja e datës së marrjes së njoftimit”. Besoj se këtë të drejtë ...

Arben Ahmetaj – Mund të sugjeroj diçka, nëse më lejon? Jo marrjes së njoftimit, por marrjes së aktit.

Anastas Angjeli – Akti është njoftim.

Arben Ahmetaj – Jo, akti është akt në bazë të procedurës. Nuk ka rëndësi, jemi duke folur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Me gojë nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Në rregull, jemi duke thënë të njëjtën gjë. Pra, jo pas njoftimit, sepse atë doni ju, dhe filloni të thoni për çfarë njoftimi e keni fjalën, të kemi njoftuar para 15 ditëve.

Anastas Angjeli – Dakord, e lëmë aktin. Pikat e tjera të këtij neni do të rirenditen duke marrë parasysh të gjitha sugjerimet. Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Te pika shtatë thuhet: “nënshkruhet nga inspektori/inspektorët, të cilët kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor”. Duhet të jetë “edhe nga subjekti”

Anastas Angjeli - Prandaj vjen neni tjetër, që subjekti të ankohet, që bën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e nënshkroi s’ka të drejtë të ankohet, sepse e ka pranuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të drejtën e ka.

Arben Ahmetaj – Më falni, praktika e ka për kontrollet e thelluara dhe e drejta e apelimit është gjithmonë. Në tipologji kjo është vizitë fiskale, por me synim kontrollin e lëshimit të faturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më besoni që është normale, sepse jemi duke folur për lëshimin e faturave. Fatura është institucion bazë, prandaj duhet forcuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka nevojë ta firmosi. Nëse subjekti nuk do ta firmosë, mjafton ta firmosin inspektorët, sepse e kanë kapur në shkelje. Ja faturën ku e ke, ja sistemin ku se ke, fotografohen të dyja ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Niko, të lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U kujtove vonë, sepse u morëm vesh. E kupton që u kujtove pas pesë minutash për këtë dhe reagoje me vonesë? Jemi duke folur për faturat që do t'i shkosh në mënyrë të beftë. Nuk do ta njoftosh, thamë.

Pse pas pesë minutave, apo ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe 15 ditë është shumë, por, nejtë, nuk ka rëndësi, sepse, vetë e keni sjellë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi të qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Nuk e ke me ligj që të shkojë një.

Arben Ahmetaj - Nuk prish punë ajo.

Turi, mendoj se nuk prish punë “inspektori” apo “inspektorët”, sepse mund të jetë edhe një tek.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, bën vizitë fiskale tek iks dyqan për të kontrolluar lëshimin e kuponit dikur, të faturës nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të kap sistemi e ke hedhur, apo jo?

Unë të kap në flagrancë me shitjen dhe po të kap sistemi që nuk e ke hedhur faturën. Që në këtë sekondë ti je kapur në flagrancë. E argumenton me atë dhe bëhet procesverbal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Edlira Hyseni – Në pikën 9, raporti plotësues që bëhet në rastin e raportit, është detyrim t'i dorëzohet kopje ose të vihet në dijeni edhe tatimpaguesi për këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu e shtuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal!

Arben Ahmetaj – Në rregull. Të falenderoj, gjithsesi!

E hedhim në votë. Pra, nuk ka nevojë që ta nënshkruajë sipërmarrja?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Pas nenit 15 do të shtohen dy nene, për të cilat pothuajse jemi rakorduar edhe me Ministrinë e Financave, neni 16, që shtohet, jo ekzistuesi.

Arben Ahmetaj – Pra, neni 16 i ri që do të numërohet normalisht pasi të numërohen nenet.

Anastas Angjeli – Po.

Pas nenit 85 shtohet neni 85/1 me përmbajtje si më poshtë:

1 – Administrata tatimore, nëpërmjet strukturave të saj të verifikimit në terren, kryen verifikimet në terren, të cilat synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm, identifikimin e personave të paregjistruar dhe të ndryshimeve në regjistrimin dhe përdorimin e pajisjeve fiskale, me dokumentin e mallrave në ruajtje, përdorimin dhe transportin me dokumentin e çdo transaksioni shitjeje të mallrave, apo të shërbimeve dhe lëshimeve të faturave tatimore në regjistrimin e punonjësve, e të tjera. Këto verifikime kryhen pa njoftim paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm përmes prezantimit në momentin e verifikimit të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin ditor të punës të lëshuar nga drejtori i Drejtorisë së Verifikimit në terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

2 – Administrata tatimore merr masa administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të evidentuara gjatë verifikimit në terren.

Neni 16. Kush është dakord?

Arben Ahmetaj – Unë kam një pyetje për shërbimet e Kuvendit dhe për Nikon ose drejtoreshën.

Mund të ndryshojë struktura?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I jeni referuar në përgjithësi shefit të shefit? Jeni referuar me emërtime strukturash, sepse nesër mund të ndryshoni strukturat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahimaj – A mund ta rregullojmë me shërbimin mënyrën e të shprehurit në mënyrë që të mos ngatërrohet?

Arben Ahmetaj – Drejtoreshë, ju lutem, nesër ndryshon struktura dhe nuk jepni dot më urdhra. Mos na përdorni edhe ju si asistentë, sepse u bëmë asistentët tuaj. I Nikos bëhem, sepse me Nikon kam 30 vjet që punoj.

Anastas Angjeli – Këtë punë kam bërë edhe te neni ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – Më vjen mirë që kursehen taksapaguesit dhe në vend që të shkruhen në ministri, po i shkruajmë ne, kështu që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Në vazhdim të ... 1 me përmbajtje si më poshtë:

Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet në mënyrë të centralizuar në drejtoritë e mbledhjes së detyrimeve të papaguara të rajonit Qendror, Verior dhe Jugor. Këto drejtori varen nga ana funksionale dhe procedurale nga drejtoria e mbledhjes me forcë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kush është pro?

Kthehemi te nenet që ishim.

Arben Ahmetaj - Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Çfarë ke, Niko?

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Neni 3 ose neni 18 me numërimin që bëjmë me shtesën. Në kreun XI nga nenet 88 deri 104, ku përmendet “drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”, zëvendësohet me “drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara të Rajonit Qendror, Verior ose Jugor”.

Arben Ahmetaj – Është ligji për procedurat. Do të ndryshoni strukturën? Çfarë jeni duke bërë?! Do ta ndryshoni strukturën një ditë, por do të vijë FMN-ja, do të dalë një strukturë më e re, do të keni eksperiencë më shumë...

Anastas Angjeli – Do të na sillni përsëri ndryshime.

Arben Ahmetaj – Do të sillni pastaj: personi përgjegjës për këtë, personi përgjegjës për atë, drejtoria përgjegjëse për atë. Mos i nominoni strukturat.

Anastas Angjeli – Edhe një herë, neve nuk na gjen asnjë gjë që t’jua lëmë. Ju do të vini përsëri këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vajtje-ardhje vajti kjo punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Domethënë, vendosni referenca, standarde gjeografike dhe përgjegjësish që të mos na vini gjithë kohës dhe të filloni të alarmoheni në korridoret e

Ministrisë së Financave se duhet të ndryshoni ligjin për një nominim strukture dhe e mblidhni pastaj komisionin më 28 dhjetor.

Anastas Angjeli – Bim dakord që të kemi një mirëkuptim midis përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe stafit për këto 3 fjalë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Arben Ahmetaj – Miratohet edhe me votat e opozitës.

Anastas Angjeli – Kthehemi përsëri atje ku ndërhyrje. Ne ndërhyrje pas nenit 15, që i bie të jetë neni 19 ose neni i vjetër 16. Ti i rregullon këto. A je dakord? Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në nenin 16 të projektligjit që ka sjellë qeveria, për teknikë legislative sugjerojmë që, përpara përcaktimit të shtuar “sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit të Financave” të shtohen fjalët “shqiptare të nivelit të dytë”. Kemi rënë dakord, nuk ka ndonjë ankesë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ndonjë ndryshim.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 18. Sugjerohet që në pikën 2, që shton pikën e re 4 të nenit 96 të ligjit bazë pas fjalëve “të zbatohen për” të shtohet fjala “shitjen e”, sepse mungonte dhe fjalia dilte pa kuptim.

A keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Arben Ahmetaj – Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Urdhëroni!

Edlira Hyseni – Dua të tërheq vëmendjen vetëm për diçka. Të gjithë i kemi përpara ndryshimet e paketës fiskale që ka propozuar qeveria dhe na i ka sjellë, jo amendimet dhe propozimet e reja që keni ju. Po përpiqemi t’ju ndjekim ju për të kuptuar çfarë po ndryshojmë nga ajo që po ndryshon. Ne nuk i kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po ndryshoni ndryshimet dhe ne nuk i kemi ndryshimet e ndryshimeve.

Arben Ahmetaj – Në rastin konkret quhet korrigjim i draftndryshimeve, në reflektim të ligjit bazë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Pse nuk ia jepni?

Mirëkuptojeni shërbimin e Kuvendit për një arsye: ashtu siç e shikoni, te ligji i formalizimit nga 50 nene prekëm 48 nene. Mund ta kishim shkruar edhe vetë. Këtu nga 22 nene kemi prekur 20 nene, hiq dy nene shto dy nene. Mirë është që, kur fillon kjo stina e ndryshimeve, të shkojmë të punojmë te kati i parë i Ministrisë së Financave dhe jemi në rregull ose te Drejtoria e Tatimeve.

Votojmë nenin 19, sepse nuk ka ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, paskeni kohë sot pafund.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë.

(Mungesë regjistrimi)

Neni 20. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 21 ka dy ndryshime. Ndryshon pika 2 sipas përmbajtjes së më poshtme: “Personi, i cili ushtron veprimtari ekonomike, tregtare i paregjistruar, sipas përcaktimeve të nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej 100 mijë lekësh”.

Pika 3, për saktësim dhe teknikë legislative, riformulohet, në rast se për shkeljet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni evidentohet kryerja e evazionit fiskal. Sipas parashikimeve të nenit 116 të këtij ligji, administrata tatimore kallëzon penalisht tatimpaguesin në përputhje me parashikimet e nenit 131 të këtij ligji. Kush është dakord? A ka vërejtje ose pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për cilën pikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pyetje me vend.

Urdhëroni, zoti Zëvendësministër!

Elton Haxhi – Si ishte pyetja?

Anastas Angjeli – Kemi pikat “a”, “b” dhe “c” që përcaktojnë masën e gjobës dhe më pas kalojmë te pikat 2 dhe 3 që i ndryshuam. Pra, për pikat “a”, “b” dhe “c” si ishte dhe sa bëhet?

Arben Ahmetaj – Zoti Zëvendësministër, a doni kafe, sepse e shikoj që paskeni nevojë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’ju lutesha që ju të katër ditën që do të falënderojmë shkruesit e ligjeve, edhe të atij të paradites dhe të këtij, të vini, sepse kemi nevojë t’ju falënderojmë në veçanti pa kamera.

Zoti Zëvendësministër, përgjigjuni pyetjes së deputetes!

(Diskutime pa mikrofon)

Delina Ibrahim – Për diskutime të moslëshimit tatimor ka qenë 50 mijë lekë në rastin e parë dhe në rastin e dytë. Ne e kemi ndarë, e kemi bërë 50 mijë lekë për biznesin e vogël, 100 mijë lekë për biznesin deri në 800 mijë lekë...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, rastin e dytë e kemi dyfishuar, por kemi hequr konfiskimin. Kemi pasur mbyllje për 30 ditë të aktivitetit, ndërkohë tani kemi lënë gjobë dhe mbyllje deri në pagim të detyrimit.

(Diskutime pa mikrofon)

Po për moslëshim fature, e njëjta gjë është. Tani kuponi quhet faturë, nuk ka më....

(Diskutime pa mikrofon)

Është po dyfish gjoba, por shkon në prokurori siç ka qenë, pra shkon për hetime të mëtejshme; nuk e kemi ndryshuar.

Arben Ahmetaj – Pra, keni rritur gjobat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahim – Hetimi ka qenë, nuk e kemi ndryshuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi ulur afatin, sepse më përpara nuk ka pasur një afat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zonja drejtoreshë, zoti Angjeli si relator ju pyeti: a i keni rritur trefish gjobat, po apo jo?

Elton Haxhi – Është për kategori të ndryshme.

Arben Ahmetaj – Për kategori të ndryshme i keni rritur gjobat trefish?

Delina Ibrahim – E kemi rritur dyfish gjobën për rastin e dytë dhe trefish për rastin tretë, por këtu kemi bërë një lehtësim. A mund të bëjnë sqarim?

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Delina Ibrahimimi – Më parë nuk ka pasur një afat, pra gjoba e parë, e dyta dhe e treta mund të ishin që nga fillimi i aktivitetit të biznesit, ndërkohë që tani janë brenda një viti kalendarik. Pra, nëse merret një gjobë në datën 25 dhjetor, në datën 1 janar nuk quhet rasti i dytë, quhet përsëri rasti i parë. Ky është lehtësim për biznesin.

Arben Ahmetaj – Nuk jam dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Drejtoreshë, që ta kuptojmë situatën: mbyllet pasi kapej pa kupon herën e parë dhe herën e dytë, pra herën e parë merrje gjobë dhe herën e dytë mbylleshe, dhe mund të ishte brenda një viti, mund të ishte edhe brenda 3 vjetëve. Drejtoresha e quan lehtësi, unë personalisht, nuk e influencoj komisionin, por nuk bie dakord me logjikën tuaj. Ai në qoftë se e ka bërë një herë, i numërohet një herë dhe nuk i fshihet. Pse vitin tjetër u përmirësua ky?! Çfarë ndodhi, filloi nga e para? E fshiu ky dhe fillon nga e para numërimin?! Jo.

Së dyti, gjoba dyfish. Cila është arsyeja e gjobëvënies dyfish? Çfarë nuk ju ka funksionuar në terren që doni ta rrisni gjobat dyfish dhe trefish? Konkretisht çfarë? Është shumë e rëndësishme kjo gjëja.

Delina Ibrahimimi – Moslëshimi i kuponit për herë të dytë është më i rëndë se sa moslëshimi për herë të parë, sepse biznesi është penalizuar një herë...

Arben Ahmetaj – Po herën e dytë e mbyll?!

Delina Ibrahimimi – Jo, në këtë rast e mbyll deri në pagesën e penalitetit. Nuk e mbyll për 30 ditë, siç është sot.

Arben Ahmetaj – Çfarë ke bërë ti si logjikë? Kur them ti, nuk po flas ti si, Delina, ndjesë, por po flas ti si administratë dhe si ministri. Ti thua unë nuk të mbyll 30 ditë, por unë ty do të të mbyll deri kur të paguash penalitetin. A është kështu?

Delina Ibrahimimi – Po.

Arben Ahmetaj – Pra, ti thua: hajde të paguash një penalitet trefish tek unë dhe hapu. Kështu është?

Delina Ibrahimimi – Në rastin e dytë po, dyfish.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, zonjë, mos ndërhyjni! Keni gjithë kohës që ndërhyjni. Unë jua kam dhënë fjalën 100 herë. Të kuptojmë procedurën, sepse është e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë po thoni ju? Më fal, penalitetin e kujt, zonjë?!

Delina Ibrahimimi – 50 mijë lekëshi në rastin e dytë është 100 mijë lekë.

Arben Ahmetaj – Domethënë, në qoftë se ai ka shmangur 200 mijë lekë, nuk ka rëndësi, ti e ke me penaltitet 100 mijë lekë, sepse ti, kur e ke kapur një herë, ai mund të ketë shmangur 1 muaj të tërë, por ti një herë e kape dhe ai mund të ketë shmangur 3 milionë lekë. Ndërkohë, penalti 1 muaj mbyllje është më i duhuri dhe duhet të jetë taksativ. Nuk keni nevojë të bëni nga këto: shtoni gjoba dhe më pas hajde paguaj gjobën ti. Kjo është kapja e veshit të majtë me dorën e djathtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Nga njëra, ajo që thotë kryetari, biznesi i kursen xhepit të tij mosdeklarim 3 milionë lekë të vjetër, por thotë shumë mirë se po shkoj tek tatimet, po paguaj 1 milion lekë të vjetër dhe jam në rregull. Pra, ju e incentivoni biznesin që nuk deklarojnë. Kështu më duket mua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Unë jam me propozimin e zotit Angjeli. Zoti Angjeli thotë: të rregullojmë gjobat, 30 ditëshi i mbylljes mbetet dhe kthehet në taksativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kanë qenë gjoba dhe mbyllja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Problemi është: a do të trefishohet apo dyfishohet, apo do të mbeten gjobat më të ulëta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, por pa gjobë nuk mund ta lësh tjetrin, në qoftë se ka shkelur ligjin.

Artur Roshi – Dhe ti marrësh të gjithë pasurinë atij ose të gjithë djersën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, ndjesë që ta kuptojmë!

Cila është arsyeja që ju kërkoni këtë ndryshim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahim – Arsyeja e heqjes së mbylljes për 30 ditë është bërë nisur nga eksperiencia...

Arben Ahmetaj – Nga cila eksperiencë?

Delina Ibrahim – Nga eksperiencia e terrenit që shumë subjekte e kanë anashkaluar mbylljen e afatit për 30 ditë, duke shkuar në gjykatë dhe duke e hedhur poshtë apo duke e pezulluar për një afat 6-mujor gjobën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po mirë me gjobën trefish i keni hequr të drejtën e shkuarjes në gjykatë për të anashkaluar gjobën?

Delina Ibrahim – Jo.

Arben Ahmetaj – Atëherë, mbetet procedura siç ishte dhe kthehet në taksative. Pra, kur them taksative, 30 ditëshi është automatik.

Po herën e tretë çfarë më bëni, kur më kapni se nuk kam lëshuar faturë, sepse kuponi, zonjë, nuk ekziston më si term, është faturë. Pra, kur më kapni herën e tretë, çfarë më bëni?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahim – Siç është aktualisht në ligj.

Arben Ahmetaj – Si është?

Delina Ibrahim – Procedohet për ndjekje penale.

Arben Ahmetaj – Çfarë më bëni kur më kapni herën e tretë pa kupon?

Delina Ibrahim – Subjekti shkon në prokurori, nuk shkon në burg dhe prokuroria vendos. Aktualisht kështu është ligji.

Arben Ahmetaj – Herën e tretë më mbyll përsëri?

Elton Haxhi – Përveç penaliteteve të herës së dytë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk e pyes kot, sepse i quhet herë e parë, nuk i quhet herë e tretë.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra i quhet herë e parë, por e thonë kot. Ditën kur unë jam mbyllur 30 ditë, po u kapa pas 30 ditëshit, mua nuk më quhet herë e tretë, më quhet herë e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko, si është?

Nikolla Lera – Është e shkruar në këtë mënyrë: “Tatimpaguesi i cili për herë të tretë brenda vitit kalendarik thyen shkeljet e përcaktuara në gërmat “a”, “b” dhe “c” në pikën “gj” të këtij neni...”.

Arben Ahmetaj – Dispozita aktuale?

Nikolla Lera – Jo, kjo që më keni sjellë. Pra, në gërmat “a”, “b” dhe “c” në pikën “gj” të këtij neni, përveç dënimit, sipas pikës 3 të këtij neni, procedohet me ndjekje penale sipas pikës 2 të nenit 116...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Na hutove. Nuk po lexon atë që po diskutojmë. Jemi te neni 21, që ndryshon 121. Asnjë nga fjalët që the nuk janë në atë nen. Edhe një herë, Niko, mos na lexoni këtu gjëra të tjera, nuk mashtrohemi ne. Edhe një here: neni 21, që ndryshon 121, thotë:

“Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore: 1) për tatimpaguesit që mbajnë në ruajtje...” pastaj me radhë pikat “a”, “b” dhe “c”. Zoti Arben të kërkoi si është në ligjin aktual që keni sjellë këtë ndryshim. Ju na keni sjellë ne këtë ndryshim: pikën “a” e lini 50, pikën “b” e keni ndarë dhe e keni dyfishuar dhe pikën “c”, duke devijuar që në pikën “b” nuk shkoni më në prokurori, kurse në pikën “c” shkoni për hetim. A është kjo?

Nikolla Lera – Keni plotësisht të drejtë.

Anastas Angjeli – Kam plotësisht të drejtë! Mos na e lexoni neve nenin 116.

Nikolla Lera – Debati i kryetarit në këto 10 minuta ishte për nenin 23, prandaj unë lexova...

Anastas Angjeli – Ti e di për çfarë ishte debati?!

Arben Ahmetaj – Niko, nuk ke marrë leje të flasësh.

Nikolla Lera – Më fal!

Arben Ahmetaj – Niko, të ta them ty, sepse më keqkupton komisioni. Unë ta respektoj dijen, durimin, edhe kontributin që ke në 30 vjet.

Të veçoj nga të gjithë, në qoftë se do ta dish! Dhe, kur të drejtohem ty, të drejtohem për shkak të besimit, ta dish! Prandaj, merre me durim!

Imagjino tani që, në vend t’i shkruanit ju, i kemi shkruar ne dy ligje!

Duroni pak tani, se bëjmë punë tani që të mos ketë problem terreni ekonomik! Ju na sillni klauzola, të cilat nuk na qëndrojnë! Pse? Sepse nuk keni pasur... Ju thoni: “Shiko, se ai me gjykatë e hoqi, ndërsa unë tani do të sjell një gjobë plus dhe do...”. Por nuk shkon si logjikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, do të duhet që të rrijë (madje do ta votojmë) procedura siç është dhe do të shtojmë që për herë të tretë brenda vitit kalendarik shkon për ndjekje penale; ta shtojmë atë. Si mendoni, zoti Angjeli?

Anastas Angjeli – Patjetër, e kemi diskutuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Çfarë thatë, zonja drejtoreshë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku është aktualisht?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos flisni me njëri-tjetrin! Një sekondë! O Landi, mos e bëni këtë rrëmujë!

Zonja drejtoreshë, kam një pyetje: në cilin legjislacion është herë e tretë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, fol me mua! Shtype mikrofonin dhe fol me mua!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në cilin nen aktual?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, duro! Nuk është politike, besojë Benin këtë herë; është teknike!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, more, do të ta jap fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, një moment!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi, zonja drejtoreshë? Ju lutem, se e bëmë rrëmujë, por këtu do të jemi!

Turi, më beso një sekondë të vetme!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja drejtoreshë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A jeni mirë, apo nuk jeni mirë?! O ju të ministrisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pyes: ku është sqarimi se çfarë ndodh herën e tretë brenda vitit kalendarik në atë që është sot në fuqi? A ka sot ndonjë klauzolë që është në fuqi për herën e tretë? Niko ka, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Po, është në nenin 122 të ligjit ekzistues...

Arben Ahmetaj – Ekzakt.

(Zoti Lera flet pa mikrofon.)

Nikolla Lera – “Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale për lëshimin e kuponëve fiskalë dhe të biletave”; është nen shumë i gjatë.

Arben Ahmetaj – Herën e tretë.

Nikolla Lera – Ta lexoj të gjithë nenin?

Arben Ahmetaj – Jo, vetëm pjesën ku përfshihet hera e tretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po e pyes.

Nikolla Lera – “Çdo konstatim i përsëritur i moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të sipërpërmendura, përveç aplikimit të dënimit, konsiderohet evazion tatimor sipas pikës 2 të nenit 116 të ligjit. Gjithashtu, publikohen emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri

i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Një sekondë, se është e rëndësishme! Ndiqeni pak!

Nikolla Lera – Koncepti i riformulimit të neneve të reja është i njëjtë me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pse na e harxhoni kohën me të njëjtat gjëra?! Atë po ju them. Prandaj të pyeta në detaje! Tani ke shtuar që shkon për ndjekje penale! Ndërkohë, kur konsiderohet evazion, shkon për ndjekje penale. Pse i bëni këto veshi i majtë me dorën e djathtë? Pse i bëni këto? Kemi një orë që diskutojmë!

Unë sugjeroj që kjo klauzolë të mos ndryshojë. Ju gjykojeni vetë, të dashur deputetë! Madje t’u japim edhe një mësim të mirë shkruajtësve: çfarë domethënë kjo tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Atëherë, përfundimisht për nenin 21, që ndryshon nenin 121, pika 1 dhe germa “a”, “b” dhe “c” mbeten siç ishin, ndërsa pikat 2 dhe 3 ndryshojnë siç u propozua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E lamë siç ishte pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ore! E dëgjuat?

Arben Ahmetaj – Zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ore, ne e mbyllëm, kurse ti thua...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ja të ta shpjegoj unë!

Zoti Angjeli, me lejen tuaj, meqenëse jeni relatori...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Mirë, por është me votim!

Arben Ahmetaj – Më falni pak!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ngrije dorën dhe thuaje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me leje? Urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Po, Landi, patjetër. Do ta thuash, me lejen tënde, por pasi unë të shpjegoj se çfarë vendosëm parapakisht! Pastaj, ti mund...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë vendosëm paraprakisht, pastaj do të votohet!

U vendos që klauzola, neni ku preken hera e parë dhe e dytë, herën e parë është me gjobë, e cila nuk ndryshon; herën e dytë është me gjobë dhe me mbyllje 30 ditë (nuk ndryshon), ndërsa hera e tretë nuk ndryshon, sepse i kanë.

Nuk kemi nevojë të prekim asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lehtësimi që ju kujtoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Landi, nuk ta jap fjalën!

Faleminderit!

Artur Roshi – Do të ma japësh mua fjalën! Ma jep!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me propozimin tim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Zoti Ahmetaj!

Edlira Hyseni – Ka një lehtësim që e heq atë...

Artur Roshi – Jo, çfarë lehtësimi! Prisni ta propozojmë këtu dhe ta ndryshojmë komplet! Çfarë muhabeti është ai?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Biznesi këtu nuk është armiku i popullit, Niko!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ahmetaj!

Arben Ahmetaj – Po, i dashur!

Artur Roshi – Po më zhgënjëni tani, pasi dy-tri qasje në fjalë i patët pro-business në nenet e shkuara, ndërsa tani po e rrëzoni të gjithin. Biznesi është i brishtë në mënyrën e sjelljes dhe duhet të jemi të kujdesshëm, me një fjalë, ndaj administratës tatimore. Biznesi ndaj administratës tatimore është shumë i ndjeshëm.

Arben Ahmetaj – Ah, sa të lehtë e keni këtë të flisni ashtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Më lini të mbaroj!

Tani, le të marrim një rast të thjeshtë. Të kapi polici pa rrip sigurie, herën e dytë, polici mban shënim. Pse të mos jetë që sa herë kapesh, aq herë gjobitesh. Pse duhet me shkallë:

shkallë e parë, shkallë e dytë, shkallë e tretë?! Sepse këtu vetëm shkallë e pushkatimit nuk mungon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në qoftë se ne themi këtu që, po u kap për herë të katërt, ta pushkatojmë direkt...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, more, nuk e kam gabim, e kam shumë mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, Landi, se jam për t'i zbutur masat! Nuk e kam gabim unë, prit!

Kur shkon tek e dyta, me mbylljen...

Një sekondë, ta mbaroj!

Mbyllja është e gabuar këtu. Keni mbyllur me mijëra biznese në Tiranë me mbylljen njëmuajore që keni bërë. Në qoftë se e mbyll biznesin për një muaj, si mund ta ngresh biznesin pas një muaji për një faturë tatimore?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti gjobën ia vë, ia mbyll edhe një muaj, e ke falimentuar totalisht.

Edlira Hyseni – Nuk jemi dakord.

Artur Roshi – Nuk arrin ta çosh më te prokuroria herën e tretë, pasi e ke mbyllur atë biznes. Për mua mbyllja duhet të hiqet, pastaj ju bëni çfarë të doni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Faleminderit, sepse sapo thatë thelbin!

Thelbi është që nuk gjobitet. Mbyllja është preventivuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ta mbaroj, se unë nuk ju ndërhyra!

Mbyllja është preventivuese. Ajo që thatë ju, biznesi të mos bjerë në burokracinë e administratës, por të lëshojë faturë. Herën e parë gjobitet, herën e dytë, ta kuptojë, është çështje e zbatueshmërisë së ligjit. Mbyllja i dhemb më shumë sesa gjoba, që do të thotë se është preventivuese, ndërsa gjoba kalon në...

Artur Roshi – Por cili është qëllimi këtu, ta mbyllim biznesin, apo ta ndihmojmë që ai të paguajë natyrshëm, ta edukojmë?

Arben Ahmetaj – Ta ndihmojmë që të paguajë natyrshëm.

Artur Roshi – Nuk e edukon rritja e këtyre masave shtrënguese. Kështu, në shkallë sipërore, nuk e edukon. Nuk edukohet njeri me masa shtrënguese! Shiko se diktaturat kështu kanë ekzistuar, me masa shtrënguese! Nuk edukohet njeriu me masa shtrënguese; ne jemi në liri!

Arben Ahmetaj – Dakord.

Artur Roshi – Në liri ka ndërgjegjësim, ndërkohë që gjoba...

Arben Ahmetaj – Bëni propozimin tuaj.

Artur Roshi – Edhe në mënyrë simbolike po ta paguash ti, djersën nuk ka ndërmend askush ta falë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Suzana Topi – Bëjeni 10 ditë këtë 30-ditoren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – 23.

Në vazhdim të njëri-tjetrit, këto ligje janë në mënyrë progresive vetëm për problemin e gjobave. Unë ju propozoj që, përveç rregullimit të propozuar nga pikëpamja legislative, që nuk ka lidhje me shifrën e gjobave, për nenin që po e diskutonim deri tani të mbetemi në variantin që ishte për masën e gjobës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për dy nenet e tjera që kërkojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, po deshët, dëgjoni deri në fund!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thamë sa ishte gjoba, aq sa ishte!

Për dy nenet e tjera, të cilat nga rasti i parë, në rastin e dytë dhe në rastin e tretë i dyfishojmë dhe i trefishojmë gjobat, të përgjysmohet baza e gjobës që dyfishohet. Në qoftë se ai thotë: ishte 50 dhe në rastin e dytë të bëhet 100, ne themi: të ishte 25 dhe të bëhet 50. Domethënë, për rastin e dytë, në qoftë se thoshte: ishte 100 dhe të bëhet 200, të jetë 50 dhe të bëhet 100. Për rastin e tretë, në qoftë se ishte 200 dhe thotë: të bëhet 400 apo 600 sa i bie, të marrim përsëri 50-tën, herë 2 apo herë 3, 150. Pra, t'i përgjysmojmë të gjitha ato që kanë propozuar këta. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi te masat. Po jap nivelin e gjobave.

Evis Kushi – Dakord jemi.

Anastas Angjeli – Nuk jam duke thënë nivelin e ndonjërës prej masave shtrënguese që është propozuar apo është lehtësuar.

Jeni dakord me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni dakord.

Para se të votojmë, dëgjojmë edhe zëvendësministrin. Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Ndryshimet që kemi propozuar ne kanë...

Anastas Angjeli – Flas vetëm për nivelin.

Elton Haxhi – E kuptova, por përveç shumëfishimit të gjobës, e kanë ndarë gjobën sipas kategorisë së biznesit.

Anastas Angjeli – Siç është atje, por përgjithmonë.

Elton Haxhi – Po pra, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, do të ecim me nivel të përshkallëzuar? Biznesi i vogël më pak?

Anastas Angjeli – Po, po.

Elton Haxhi – Sepse nuk bën sens që çdo kategori...

Anastas Angjeli – Po përgjysmimi bazën, ke përgjysmuar dyfishin e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Biem dakord?

Elton Haxhi – Po.

Anastas Angjeli – Atëherë, kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Vetëm për nivelin e gjobave, pra mbyllja nuk ikën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjo mua tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Dakord pra.

Arben Ahmetaj – Përsëriteni, në mënyrë që të regjistrohet!

Anastas Angjeli – Me regjistrim i dhashë të gjitha përgjysmimet e të tria neneve: 21, 22 dhe 23. Kemi mbetur vetëm te masat shtrënguese.

Cili ishte propozimi juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Që nuk hiqet mbyllja e biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Një minutë, se ka dy propozime: ku njëri është propozimi i zotit Ahmetaj që nuk hiqet masa shtrënguese, tjetri është propozimi juaj që hiqet masa shtrënguese.

Arben Ahmetaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se kemi një orë e gjysmë me logjikën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, pas logjikës vazhdojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – E hedhim në votim.

Anastas Angjeli – Kush është pro propozimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush është pro propozimit?

Anastas Angjeli – Më lini, se e hedh unë në votim!

Kush është pro propozimit të zotit Ahmetaj, të ngrejë dorën.

Arben Ahmetaj – Vullnet, ngrini dorën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Unë jam pro biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Çfarë po thua?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Je mirë, apo nuk je mirë? Do ta diskutojmë në grup. Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ç’ke, ore vëlla, se e votojmë në parlament?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush është pro? Shtatë vota pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetari jam unë. Kush është kundër? Nuk ka vota kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, iku në punën e tij ai!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E komandoj unë, jo ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komisionin!

Jo, more, ç’punë kam me Benin unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të jetë për Benin, do të pres të gjithë grupin unë këtu!

Anastas Angjeli – Nuk kemi kohë tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Atëherë, fiton propozimi im.

Ecim. Kush është pro?

Anastas Angjeli – Neni 24.

Roland Xhelilaj – Këtu, te masa e bllokimit: “Sipas germës “c” të kësaj pike hiqet nëse tatimpaguesi paguan penalitetet e vendosura”. Bie kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e ke këtu!

Arben Ahmetaj – E hoqëm.

Roland Xhelilaj – Kur e hoqëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Votove propozimin tim që ngelej penaliteti.

Edlira Hyseni – Jo, nuk votoi ai!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem tani! Çfarë pune ke ti se si voton ai?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ecim, se e votuam.

Vazhdoni, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Jemi te neni 24. Ju lutem, kini vëmendjen!

Neni 24 propozon ndryshimin e nenit 124 të ligjit. Në pikën 1 të këtij neni, germa “a”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk kam çfarë t’ju bëj...

Anastas Angjeli – ...për teknikë legjislative, sugjeroj që fjalët “të cilat...

Ju lutem, ta mbaroj fjalinë dhe pastaj flasim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Turi, të lutem, mos e merr fjalën pa leje!

Anastas Angjeli – Një minutë, të mos e bëjmë Pazar, ju lutem!

Neni 24, për teknikë legjislative, fjalët “të cilat nuk janë të regjistruar” do të zëvendësohen me fjalët “por që nuk janë të regjistruar”, sepse nuk ka kuptim fjalia.

Në rregull?

Evis Kushi – Në rregull. Hidhe në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Kush është dakord, Beni?

Arben Ahmetaj – Kush është dakord?

Të lutem, Turi, mos e merr fjalën pa leje, se do ta mbyll mbledhjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ç’punë ka zoti Angjeli? Jam unë kryetari.

Anastas Angjeli – Nuk kam punë unë, e drejton ai!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë jam relatori.

Arben Ahmetaj – Duro, more, patjetër!

E doni ndërhyrjen për nenin 24?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ke diçka për nenin 24, atëherë, e votojmë dhe pastaj thuaje.

Kush është pro nenit 24? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 24.

Fjalën e ka zoti Roshi.

Artur Roshi – Shiko, problemi është këtu: duhet t’i bindemi logjikës, jo votës. Hitleri në vitin 1936 e vuri diktaturën me votë, nuk e vuri kështu. Ndaj ne nuk duhet të jemi në diktaturën e votës, por duhet t’i bindemi logjikës së biznesit. Ju bëj thirrje ta tërheqim masën shtrënguese. Pavarësisht se ty të duket sikur kaluam nga procedura, ishte neni i mësipërm. Kaq.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 25.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Te neni 25 i projektligjit propozohet që fjalët “të cilat nuk janë të regjistruar”, duhet të shkruhen “që nuk janë të regjistruar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord?

Arben Ahmetaj – Pse, more, çfarë i them unë Benit?

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kërkova Ervinin.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë më tej, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Neni 26.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë procedurën.

Anastas Angjeli – Neni 26 ka ndryshimet e nenit 125 dhe trajton përsëri rastin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me mosruajtjen e faturës, edhe në këtë rast, Niko, kemi një rritje shumë të lartë të gjobave. Kështu që do t'i përgjysmojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozojmë përgjysmimin. Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, more, se është e rëndësishme kjo që them për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë e rëndësishme për qytetarët, pasi janë rritur gjobat dhe jo në mënyrë proporcionale. Ndaj propozojmë përgjysmimin e tyre. Jemi dakord?

Arben Ahmetaj – Më falni, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Ta mbyllim, se edhe ata janë dakord.

Arben Ahmetaj – Zoti Angjeli po propozon përgjysmimin e gjobave në nenin 26, të propozuara nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, në ndryshim pra këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë përgjysmuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Më dëgjoni mua tani! Përderisa unë i vura gërshërën, e solla në nivelet normale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Atëherë, zonjë, llogaritini dhe na i thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Këtu jemi në parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jo, Niko është pozitiv, shumë!

Anastas Angjeli – Kush është dakord me nenin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush të dha leje, more zotëri?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, mor, dorën mbaje ngritur, por nuk është e thënë të kesh marrë leje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë. Kush është pro propozimit të zotit Angjeli? Kundër? Abstenim?

Kalon edhe ky nen.

Anastas Angjeli – Neni 27 mbetet siç ishte.

Arben Ahmetaj – Kush është pro nenit 27? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 28 mbetet siç ishte.

Arben Ahmetaj – Kush është pro nenit 28? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Anastas Angjeli – Neni 29 riformulohet në këtë mënyrë.

Arben Ahmetaj – Dëgjojeni riformulimin, ju lutem, ju të Ministrisë së Financave!

Anastas Angjeli – “Udhëzimi nr. 16, datë 03.05.2010 i ministrit të Financave “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale; vendimi nr. 781, datë 14.11.2007 i Këshillit të Ministrave “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale”; sistemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Do ta bëj. Pse, more, do të të pres ty unë, që del dhe ikën?

(Deputeti Angjeli flet pa mikrofon.)

Anastas Angjeli – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jo, nuk e pres fare!

Të pres Ervinin... Rri në mbledhje këtu, por ikën e flet nëpër telefona...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai është mashalla!

Anastas Angjeli – A do të më dëgjoni? Doni të merrni pjesë që të mbarojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Kriteret për pajisjen me autorizim”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Turi!

Anastas Angjeli – Tani, unë po flas, ki respekt! Unë të respektova; të dëgjova!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të dëgjova, të konsiderova dhe të votova!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Për miratimin e tyre dhe për kriteret...

Arben Ahmetaj – Të ecim se janë çështje teknike.

Anastas Angjeli – ...për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara, për ofrimin e pajisjeve fiskale, i ndryshuar” dhe çdo dispozitë tjetër në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet”. Biem dakord?

Arben Ahmetaj – Kush është pro? E ndoqët ju, të Ministrisë së Financave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Një sugjerim.

Arben Ahmetaj – Po.

Nikolla Lera – Sepse e kishim...

Arben Ahmetaj – Shtypeni mikrofonin që të regjistrohet.

Nikolla Lera – Në fakt, ne e kishim filluar këtë nen me shprehjen “nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji” dhe me riformulimin, sipas pikëpamjes teknike “fillon udhëzimi nr. kaq shfuqizohet”. Mendojmë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, sepse janë dy akte nënligjore që lidhen me kasat, për të cilat u bë debat. Prandaj, duke thënë: “Nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji”, e lidhur kjo me nenin 30, që përcakton afatet se kur hyn në fuqi ky ligj, mendoj se duhen lënë fjalët “Nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji”.

Arben Ahmetaj – E saktë.

Nikolla Lera – Sepse po e lamë kështu: “Udhëzimi numër kaq”...

Arben Ahmetaj – E saktë, mos e zgjat!

Anastas Angjeli – Kemi hallin e kasave. Duhet ta zgjidhim se s’bën.

Arben Ahmetaj – E zgjidhim me riformulim.

(Deputeti Angjeli flet pa mikrofon.)

Dorëzoheni edhe këtë që thatë, Niko: “me fillimin e zbatimit të ligjit dhe jo me hyrjen në fuqi të ligjit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Në vendimin e qeverisë kështu është.

Arben Ahmetaj – Cili vendim qeverie?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë numri ka ky vendim qeverie?

Anastas Angjeli – Vendimi i qeverisë është...

Elton Haxhi – Vendimi nr. 717.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Më duket se është vendimi nr. 781.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Toni, e pive kafën, i dashur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Tani është neni i fundit, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi. Në qoftë se keni ndonjë sugjerim, ma thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndryshimi i nenit 29... i VKM-së që shfuqizohet, por, për efekt të kasave, duhet t'i referohemi datës së hyrjes në fuqi.

Arben Ahmetaj – Ekzakt.

Anastas Angjeli – Ndërsa tani kemi hyrjen në fuqi të ligjit: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfundimisht, përcaktimi i pikës 1 të neneve nga 1 deri 7, 9, 13, 14, pika 3, neni 15 dhe 21 deri në nenin 28, i fillon efektet respektivisht në të njëjtën datë me afatet specifike të përcaktuara në ligjin që miratuar paradite “Për faturat dhe sistemin e monitorimit dhe të qarkullimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por kemi bërë edhe një sugjerim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni sugjerim tjetër?

Arben Ahmetaj – Po, Niko.

Nikolla Lera – Kemi një merak, sepse jo të gjitha ndryshimet, pavarësisht se ne i bëmë këto ndryshime dhe ramë dakord tani me ligjin e procedurave, ndoshta duhet ta shohim edhe një herë të zbardhur ligjin.

Anastas Angjeli – Kjo nuk është çështja ligjore dhe çështje...

Arben Ahmetaj – Atëherë, kjo është çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta themi për rekord zyrtar: do të harmonizohen edhe përkufizimet, edhe procedurat, edhe datat, edhe gjuha ndërmjet të dyja ligjeve pas ndryshimeve të bëra. Pra, me këtë logjikë do ta votojmë në tërësi.

Anastas Angjeli – Para se ta votojmë në tërësi, në diskutimet e zhvilluara dje, Niko, më ndiq, kemi sugjeruar edhe që në nenin 105, germa “ç” e pikës 2 të shfuqizohet. A mbetet kjo në fuqi?

Nikolla Lera – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Çfarë rrëmuje!

Do ta mbyllim mbledhjen pas këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, vazhdoni ju, ndërkohë që unë po largohem një pesëminutësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Zoti Angjeli, atëherë, nuk do ta përfshijmë këtë pikën.

Anastas Angjeli – Nuk përfshihet?

Nikolla Lera – Jo.

Arben Ahmetaj – Atëherë, e votojmë në tërësi.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë propozimi? Është nen i votuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që mundesh.

Nuk do ta votojmë në tërësi, por do të kalojmë direkt në diskutimin e ligjit tjetër, se do t'i votojmë një nga një në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do ta votojmë në tërësi, por do të presim kalimin e të gjithave dhe pastaj në fund do ta votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Jo, nuk u votua pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk kemi votuar në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai u votua, atje dolët 7 me 6.

Edlira Hyseni – Mund të bëj një propozim, nëse merret parasysh?

Arben Ahmetaj – Ju lutem, patjetër!

Edlira Hyseni – Meqenëse jemi te ligji i procedurave dhe po...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Turi, të mbajmë qetësi, se u lodhëm, për Zotin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – E kam të shpejtë. Meqenëse jemi te ligji i procedurave dhe kemi ndryshime të ndryshimeve në disa variante, do të propozoja që në nenin 115, pika 1, lidhur me penalitetet e ndryshme që janë marrë, lidhur me njoftimin e transaksioneve vjetore të kontrolluara. Është i vetmi penalitet që ka ngelur 10 mijë lekë të rinj për çdo muaj vonesë deklarimi i njoftimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund ta bëjmë 10 mijë lekë, siç janë të gjitha për deklarim të vonuar, të jetë si të gjitha penalitetet, pra 10 mijë lekë dhe jo 10 mijë lekë për çdo muaj? Çdo gjë tjetër është harmonizuar. Është i vetmi...

Arben Ahmetaj – A është mujor deklarimi?

Edlira Hyseni – Po, por për çdo gjë tjetër e kemi ndryshuar, edhe vendimin e asamblesë.

Arben Ahmetaj – Mirë, deklarimi është mujor...

Edlira Hyseni – Është e vetmja gjobë që ka ngelur 10 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Deklarimi është mujor.

Edlira Hyseni – Jo, jo, është deklarim vjetor; është njoftim i transaksioneve vjetore të kontrolluara!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, nga 10 mijë lekë vonesë për çdo muaj...

Arben Ahmetaj – Pse bëhet për çdo muaj?

Edlira Hyseni – ...të bëhet një herë vetëm 10 mijë lekë.

Arben Ahmetaj – Di gjë pse bëhet për çdo muaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse deklarohet çdo muaj. Atëherë, mbetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Nuk e dija këtë gjë unë.

Arben Ahmetaj – Kush është pro në tërësi me projektligjin, me ndryshimet që u numëruan?

Ju lutem, fokus!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ma nxorët grykën, mor, për Zotin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro në tërësi me ndryshimet që numëruam një nga një në nene? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të numërohen votat, ju lutem!

Nëntë me gjashtë.

Tani që e mbyllëm në tërësi, po ju paralajmëroj si administratë, nëse sillni edhe një herë ligje, drafte apo akte të kësaj cilësie, do të kthehet i gjithë akti për rishikim, si dhe për sa më përket mua, pjesë e maxhorancës, do të njoftohet grupi parlamentar dhe qeveria. Unë nuk pranoj më akte të kësaj natyre, të pamaturuara në teknikë dhe në materie!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi prekur këtu pesëdhjetë e ca nene. Nuk jemi ne specialistë fiskalë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 16.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.7.2008 ‘Për taksat kombëtare’ të ndryshuar”
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”
4. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Reme Lala, Eljo Hysko.

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomise

6. Zv/Minister Z. Elton Haxhi,
7. Z. Niko Lera, Drejtor I Pergjithshem,
8. Z. Enkeleda Pipa, Drejtor I Politikave Fiskale
9. Z. Enkeleda Kuci, Pergjegjes Sektori Politikave
10. Z. Dorian Toro, Specialist

4. Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtoreshe e Pergjithshme,
5. Znj. Ilda Koja, Drejtor Juridik
6. Z. Klodi Plloca, Drejtr IT

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime...”

Arben Ahmetaj – Më falni!

Për një pesëmbëdhjetë minuta, derisa të kthehem unë, mbledhjen do ta drejtojë zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Meqenëse jam edhe relator.

Arben Ahmetaj – Meqenëse është edhe relator, por që është edhe më...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Projektligji “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është projektligji nr. 9975 “Për taksat”, i ndryshuar.

Neni 1. Nuk ka ndonjë ndryshim nga diskutimi që është zhvilluar deri tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, pra, gjejeni, unë po bëj pyetjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 1. Biem dakord?

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Neni 2. Në nenin 2 të projektligjit sugjerohet që te shkronjat “a” dhe “b”, sipas teknikës legjislativë, pas fjalëve “të zëvendësohet më”, të zëvendësohet “me fjalët”, sepse nuk ka kuptim.

Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Për këtë ligj unë kam bërë një amendim dhe e kam sjellë këtu në komision që ka të bëjë me rentën minerare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me vlerën e rentës minerare që shkon në njësitë vendore, në bashki.

Dua të shpjegoj arsyen e amendimit që kam bërë. Në nenin 2 kam bërë një propozim që të shtohet një pikë tjetër 2/1 me këtë përmbajtje: “Në pikën 4 të nenit 4, paragrafi i parë, fjalët “5 për qind” të zëvendësohen me fjalët “10 për qind”, që do të thotë të ndryshohet ligji bazë, ku vlera e rentës minerare që ngelet te njësitë vendore (te bashkitë), ku janë burimet minerare, të shtohet nga 5% në 10%.

Dua të bëj një shpjegim pse jam nisur për të propozuar këtë amendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Duke qenë deputet i një zone, i Bashkisë së Selenicës, ku ka edhe miniera, si ajo e Selenicës, miniera zhavorri bituminoze, kemi naftën e Gorishtit dhe duke parë situatën ekonomike në atë bashki, që është një bashki rurale dhe e varfër, më lindi pyetja për çfarë arsye në këto zona, ku ka burime minerale, të ketë një nivel të ulët ekonomik. Bëra një studim, mora një informacion se sa ka qenë vlera e rentës minerare që kjo bashki ka përfituar. Më rezultoi se për pesë vjet bashkia kishte marrë vetëm 8 milionë e 55 mijë e 395 lekë; një vlerë shumë të vogël të rentës minerare.

Për këtë arsye unë kam dashur ta propozoj 25% vlerën e rentës minerare që të mbetet në njësitë vendore, por, meqenëse situata është e tillë, e ngarkuar nga tërmeti i datës 26 nëntor, e kam bërë propozimin për 10%. Gjithashtu, kam bërë edhe një studim për vlerën në total të rentës minerare që merr qeveria (që merr shteti) për vitin 2018 dhe për 11-mujorin e vitit 2019. Për vitin 2018 vlera e rentës minerare që ka grumbulluar qeveria ka qenë 3,9 miliardë lekë. Ligji i detyron që vetëm 5% e kësaj rente minerare të shkojë në njësitë bashkiake ose në njësitë vendore, ku janë burimet natyrore, kanë shkuar vetëm 195 milionë lekë. Në rast se do ta dyfishonim këtë, do të ishte 10%, do të shkonte në vlerën 390 milionë lekë. Pra, nuk është një shifër e madhe që e rëndon buxhetin e shtetit, por unë them që, edhe pse rritet në vlerë, i ndihmon jashtëzakonisht këto bashki ose këto zona rurale, ku janë burimet natyrore.

Të themi atë që është. Në qoftë se kemi një zhvillim në Shqipëri në zonat bregdetare, ku zhvillohet turizmi i bregdetit dhe bashkitë në këto zona janë të pasura, sepse mbledhin taksa nga hotelet, atëherë po zonave rurale, ku ka burime minerare, pse të mos u japim mundësinë e zhvillimit, duke e rritur vlerën e rentës minerare që shkon në këto bashki?

Për 11-mujorin e vitit 2019 vlera e rentës minerare, e grumbulluar e gjitha në shtet, është 3,1 miliardë lekë. Po të shpërndahej në të gjithë vendin, do të thoshte 155 milionë. Në qoftë se bëhet 10%, janë 310 milionë. Por nuk është ndonjë shifër e madhe që do ta cenonte buxhetin e shtetit. Prandaj do t’ju kërkoja që ta mbështesnit propozimin tim me arsyetimin e

thjeshtë: t'u japim mundësinë atyre zonave rurale, ku janë këto burime natyrore, të shfrytëzuara deri tani dhe të papara ashtu siç duhet, sepse zonat rurale i kemi pa ujësjellës, pa rrugë; kanë probleme goxha të mëdha. Një ndihmë e tillë ndaj rritjes së vlerës së rentës minerare në ato zona do të jepte një mundësi më të mirë për zhvillimin e tyre. Unë kam shembullin e ndërmarrjes së naftës në Gorisht. Ajo zonë i jep shtetit dhe qeverisë 15 milionë euro në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por aty ka burime natyrore që shfrytëzohen që në vitet '60.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, nga vitet '60 deri sot, pra po shkojnë gati 60 vjet që shfrytëzohen ato burime dhe ajo zonë ka ngelur siç ka qenë. Prandaj, do t'ju propozoja që ta mirëkuptonit dhe ta mbështesnit amendimin tim për ta shtuar vlerën e rentës minerare për njësitë administrative, ku ndodhen burimet natyrore nga 5% në 10%.

Faleminderit për vëmendjen!

Anastas Angjeli – Ju lutem!

Kam dy komente.

Së pari, në parim ky është një shqetësim që ngrihet dy vjet radhazi jo vetëm nga Vullneti, por është bërë edhe një diskutim shumë i gjatë ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe qeverisë për ta diskutuar çështjen e rentës minerare në përgjithësi, jo thjesht për rastin e veçantë.

Në diskutimet që janë zhvilluar, nuk është rënë dakord në parim për prishjen e sistemit nga lart-poshtë që, pavarësisht nga vendndodhja e një burimi mineral, të pretendohet që të ardhurat e siguruara nga ky burim t'i përkasin territorit apo pushtetit lokal, ku ndodhet ky burim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse, po të nisesh nga ky parim, në territorin e Republikës së Shqipërisë ka burime minerale të ndryshme, të cilat sigurojnë të ardhura të konsiderueshme. Ky ka qenë argumenti i dhënë deri sot. Unë e lë këtu që të diskutohet edhe me Ministrinë e Financave.

Së dyti, cenon edhe parimin e sistemit buxhetor në vendin tonë. Të ardhurat që sigurohen, përqendrohen në buxhetin e shtetit dhe shpërndahen sipas funksioneve, qëllimeve dhe programit që ka qeveria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të përmbushur të gjitha detyrimet e programit të qeverisë.

Shqetësimin që paraqiti Vullneti e kam diskutuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që çfarë mund të bëjmë për ta zgjidhur këtë. Nga Ministria e Financave, ja ku janë

edhe ekspertët këtu, të cilëve do të desha t'u jepja fjalën qoftë Nikos, qoftë zëvendësministrit, na është dhënë përgjigjja që lidhet me këto dy çështje dhe me argumentet që unë i parashtrova. Isha i detyruar që t'i thosha këtu, megjithatë, para se ne ta votojmë, do të doja që qoftë Niko, qoftë zëvendësministri, të thoshin fjalën e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Faleminderit!

Qëndrimi i Ministrisë së Financave është ai që zoti Angjeli sapo parashtroi. Për më tepër, pushtetit vendor i është dhënë një instrument i ri, ku mund të gjenerojë të ardhura, që është taksa e pronës dhe duhet ta shfrytëzojnë në maksimum këtë mundësi për rritjen e të ardhurave vendore, sepse niveli i vjeljes së kësaj takse është ende në nivele shumë të ulëta.

Kështu që ka mundësi rritjeje dhe nuk është kjo mënyra, sepse ajo është një taksë kombëtare për pasuritë kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Diskutimin për çështjet që lidhen me taksën kombëtare dhe rentat e kemi pasur ndër vite me të gjitha paketat fiskale që nga viti 2013 deri sot. Ka pasur një ndryshim të mëparshëm, ku renta ka qenë shumë më e ulët dhe e ngritëm në 5%. Por unë i bashkëngjitëm asaj që tha zoti Angjeli, po ashtu ministria që, duke qenë se janë taksa kombëtare, ne do të duhet të vazhdojmë me të njëjtën gjë: taksat kombëtare mblihen dhe më pas, sipas programit qeverisës, prioritetëve, strategjive apo investimeve strategjike, të shkojnë për të financuar ekzaktësisht këto prioritete. Ndërkohë, besoj që te pjesa e formulës për fondin e pakushtëzuar ose për buxhetin që mbështet transfertën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të konsiderohet si kriter që për të gjitha bashkitë, të cilat kanë burime natyrore të konsiderueshme, sikundër është Bulqiza, Selenica apo edhe Patosi (bashki të vogla dhe të varfra) të kemi në mënyrë të kushtëzuar një përforsim të formulës që të kenë një nivel më të lartë të fondit që të kalojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë aspekt ne mund ta zgjidhim ekzaktësisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse, nëpërmjet kësaj formule, mund të përmirësojmë edhe fondin që i shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë një kërkesë që ne e kemi pasur si komision, së paku nga viti 2013 qëkur jam unë, pra të përsëritur, si dhe një kërkesë nga bashkitë për të përmirësuar formulën. Kështu, kur

të diskutojmë nesër buxhetin, ne të kemi një mënyrë për ta reflektuar këtë kërkesë të kahershme, qoftë të bashkive, qoftë të deputetëve për zonat përkatëse.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – I dëgjova të dy kolegët. Ne nuk kemi qenë pjesë e debateve që keni bërë në vitet paraardhëse, por nisur nga fakti që kjo kërkesë e zotit Sinaj ka qenë pjesë e debateve edhe më parë, por për të cilën deri sot nuk është bërë asgjë, do të thotë që të jemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ky propozimi i fundit që nëpërmjet transfertës të rritet, të ketë tregues të veçantë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shprehem dakord në parim me zotin Sinaj, pasi mendoj që zonat, të cilat kanë burime natyrore të vetat, duhet të kenë një lloj privilegji ose të kenë, si të themi, më shumë të mira sesa zonat e tjera. Durrësi ka portin, por Durrësi nuk përfiton asgjë, ndërkohë që kudo në botë qytetet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord, por duhet të ketë diçka që qyteti atje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ajo është lënë për diskutim.

Në parim mendoj se është e drejtë, ndërsa këto formulat e korrigjimit të transfertës së pakushtëzuar ose specifike varen nga qeveria, por nuk e di nëse do të merren parasysh. Nëse do të ishte e mundur, do ta mbështesja propozimin e deputetit Sinaj.

Faleminderit!

Artur Roshi – Një fjali! Unë mendoj se këto futen te burimet strategjike, te burimet kombëtare dhe, si të tilla, nuk mund të mblidhen nga lokalitetet ose t'u adresohen më shumë atyre. Në qoftë se vijmë te linja e zotit Vullnet, ato mund ta përmirësojnë, jam dakord me zonjën Gjylameti në konceptin e ndotjes. Për shembull, nëse marrim zonën e Ballshit, ku ka burime natyrore, njerëzit mund të kenë pasoja për shëndetin. Në këtë kontekst, ata duhet të përfitojnë relativisht më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për t'u kompensuar.

Po kështu, edhe burimet minerale e ndotin mjedisin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, në këtë kontekst.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Vullnet Sinaj – Ju dëgjova me vëmendje, por, në rast se do të ishte kështu siç mendoni ju, që kjo është një taksë qendrore dhe do të grumbullohej vetëm në qendër, atëherë shtroj pyetjen: pse është parashikuar që 5% të ngelet në zonat dhe në njësitë administrative (bashkiake), ku ndodhet burimi natyror? Pra, ka një arsye.

Gjithashtu, ju tërheq vëmendjen që kjo taksë nuk ka qenë gjithmonë 5%, por ka qenë edhe 25%, që ka shkuar në zonat me burime natyrore. Është ndërruar... Ka shkuar vjet.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

U them atyre që kanë jetuar ose që i njohin nga afër këto zona se duhet të kuptojnë vështirësinë që kanë banorët e atyre zonave me minierat, me ndotjen e ambientit, me ujërat (atje ku ka burime të naftës me ndotjen e ambientit), me rrugë që shfrytëzohen nga mjetet që bëjnë transportet. Pra, është e domosdoshme të ketë një diferencim të këtyre zonave rurale (ku ndodhen burimet natyrore) nga zonat e tjera. Nuk mund të jetë 8 milionë lekë për 5 vjet e ardhura e rentës minerare në Bashkinë e Selenicës! Prandaj unë e kërkoj rritjen e saj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ku është kuptimi që një zonë është e pasur me miniera? Ku është kuptimi që qyteti i Vlorës ka detin, Durrësi ka detin, Saranda ka detin dhe janë të zhvilluara? Hajdeni t'ua u japim mundësinë edhe këtyre njerëzve që jetojnë në këto zona ta marrin dhe ta administrojnë vetë edhe një 5% tjetër!

Po jua them, nuk është shifër e madhe, por 300 milionë në të gjithë vendin, që shpërndahet që nga Bulqiza, nga Burreli, nga Peshkopia dhe deri në Selenicë e në Patos.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk është ndonjë shifër e madhe! Prandaj, do t'ju kërkoja ta mbështesim, në mënyrë që t'u japim mundësinë këtyre zonave, që vuajnë nga situata ekonomike që kanë, të kenë një zhvillim edhe ato.

Faleminderit!

Anastas Angjeli –Faleminderit, zoti Sinaj!

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, por vetëm një ndryshim, të cilin unë e lexova, para se të votojmë ndryshimin te neni 2, hedhim në votim nismën ligjore të propozuar nga zoti Vullnet.

Kush është dakord me propozimin e zotit Sinaj? Pesë vota pro.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Atë e thashë, por ai e ka që të ndryshojë tarifa, jo formula. Kështu që unë jam i detyruar që ta hedh në votim.

Kush është kundër? Pesë vota kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, dalim barazim. Atëherë, do ta bëjmë me short.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të presim të vijë kryetari.

Jeni dakord me nenin 2, me ndryshimin që propozova?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, kur rezultati i votimit është pesë me pesë, kur është barazim, nuk ka vendimmarrje. Megjithatë, do ta flasim kur të kthehet kryetari.

Kush është dakord me ndryshimin që bëra?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nivelin ta thotë edhe specialisti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtoria e Tatimeve e merr si agjent tatimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kam unë diçka si relator. Ky nen ka shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe shkronjën “d”.

Po, edhe shkronja “c”, që ndryshon “d”-në.

Neni 5 ka dy probleme. Na ka sjellë problemin e automjeteve të luksit dhe të atyre të koleksionit. Unë besoj se jo vetëm kaq, por ka edhe një problem që në dy pika trajtohet i njëjti problem. Te shkronjat “dh” dhe “c” kemi përsëri të njëjtin problem, por të trajtuar një herë si automjete të zakonshme, një herë si automjete koleksioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk e kemi sot komoditetin, i dashur Zëvendësministër, as luksin që të merremi me çështjet e makinave që koleksionohen apo të koleksioneve, por jemi në një situatë tjetër, e cila ka ndodhur edhe pas asaj, kur ju keni propozuar projektligjin.

Nuk e kemi luksin të diskutojmë për këto çështje. Kemi probleme dhe shqetësime më madhore. Prandaj unë ju propozoj që në nenin 5, i cili rregullon nenin 9, shkronjat “b” dhe “c”, që përfshijnë shkronjën “dh”, të shfuqizohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi dakord?

Atëherë, duke ju falënderuar për mirëkuptimin që tregon edhe qeveria, edhe ju të dashur kolegë, ju ftoj ta votojmë këtë me ndryshimet që propozova.

Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta lexoj edhe amendamentin tuaj, edhe pse si rregull duhet të shkonte te Kryetari i Kuvendit. Ka disa rregulla, por këtu nuk ka ardhur. Ka ardhur kjo që më dha sekretaria nga ana juaj. Unë do të ta jap fjalën.

Atëherë, nuk po e kaloj në votim, por të dëgjojmë propozimin e zotit Roshi.

Artur Roshi – Propozimi im është që shkronja “a” neni 5 të ndryshohet si më poshtë vijon:

Në shkronjën “ç” të pikës 1, pas fjalëve “...invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuara...” të shtohen fjalët “...dhe të gjithë ata që gëzojnë statusin e ish-të përndjekurve politikë, që kanë mbushur moshën e pensionit”. Pse e them këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjoni relacionin!

Me anë të nenit 5 kërkohen ndryshime në nenin 9 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Përfshirimi nga pagimet e taksave kombëtare” i ndryshuar”, të cilat synojnë shtimin e kategorisë së ish-të përndjekurve politikë, që sakrifikuan rininë e jetës së tyre për lirinë dhe demokracinë. Fjalët “veteranë lufte” ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Angjeli, dëgjojeni, sepse do të bini dakord!

Fjalët “veteranë lufte” në vlerën kuptimore të tyre kanë një kontribut të caktuar për lirinë e një vendi të caktuar. Jemi në analogji të plotë në thelbin e këtij kuptimi kur e krahasoj me kontributin e ish-të përndjekurve politikë për lirinë dhe demokracinë e vendit. Pra, veteranët humbën rininë e tyre në funksion të lirisë, sepse veteranët janë të përfshirë në ligj dhe është diçka kryesore për funksionimin e demokracisë.

Të njëjtën gjë kanë bërë edhe ish-të përndjekurit, kanë humbur rininë e tyre, kanë sakrifikuar për lirinë si koncept. Atëherë, veteranët janë të përfshirë këtu. Jam dakord që janë

një numër i kufizuar, por e njëjta gjë është edhe për ish-të përndjekurit; janë një numër i kufizuar, duke qenë se flasim për pjesën e pensionistëve. Pra, për të ekuilibruar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e papërfillshme, nuk ka lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pambarimisht e vogël, zoti Angjeli.

Kur themi se në këtë ligj përfshijmë kategorinë e kontributeve të lirisë në shërbim të sakrificave të tyre, nuk mund të bëjmë diferencime emocionale midis grupimeve të përmendura më lartë, veteranëve dhe ish-të përndjekurve, parë kjo në logjikën e këtij ligji. Për këtë arsye propozoj që kategoria me statusin e ish-të përndjekurve që kanë mbushur moshën e pensionit të përfitojnë nga kjo lehtësi fiskale në kuptimin e këtij ligji, në kontekstin e kësaj logjike që unë parashtrova. Pra, ligji aktual ...

Arben Ahmetaj – Dakord, e bëre propozimin, i cili u regjistrua.

Anastas Angjeli – Kush ka komente për këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni!

Arben Ahmetaj – Jo, do të votohet patjetër, sepse është në procedurë për t’u votuar.

Anastas Angjeli – Kush ka komente?

Arben Ahmetaj – Jo, nuk kemi nevojë për komente, që të mos bëjmë koment mbi komentin, por do të kalojmë në votim.

Kush është pro amendamentit të zotit Roshi? Kush është kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos pyet “pse”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Amendamenti rrëzohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë? Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më detyron procedura. Miqësisht, në kafe, sepse të kam mik të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu jo. Nuk kam nevojë të shpjegoj votën.

Anastas Angjeli – Kemi një diskutim të vogël për hyrjen në fuqi.

Sipas mënyrës si është paraqitur, thuhet: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe fillon efektet financiare nga data ...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjoni, sepse kërkon vëmendje!

“Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe fillon efektet nga data 1 janar”. Meqenëse diskutimi në parlament do të bëhet në datën 18, dhe 18+15 bëjnë 33, i bie data 3 janar, kemi përplasje midis datës së hyrjes në fuqi dhe fillimit të efekteve financiare. Do të kërkoj që nga ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga pikëpamja e procedurës ligjore do të kërkoj që ekspertët ta diskutojnë dhe të japin vendimin përfundimtar.

Arben Ahmetaj – Zoti Angjeli, mund të sugjeroj diçka?

Anastas Angjeli – Po.

Arben Ahmetaj – Çfarë urgjence ka përderisa këta e sjellin me urgjencë? Ne do ta kemi me hyrjen në fuqi të ligjit. Për çfarë duhet të flasim me Presidentin, që të hyjë në datën 1 janar? Cila është arsyeja?

Anastas Angjeli – Nuk e rekomandova diçka të tillë.

Arben Ahmetaj – Jo.

Anastas Angjeli – Atëherë, kush është dakord me “Hyrjen në fuqi në Fletoren Zyrtare”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Efektet fillojnë me hyrjen në fuqi. Çfarë do t’u bëjmë atyre? Do të ndjekim ata? Për ata punojmë ne?

Anastas Angjeli – Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Zoti kryetar, meqenëse patëm një diskutim për një nen në këtë çështje, për të cilin nuk patëm vendimmarrje, sepse votuam 5 me 5.

Arben Ahmetaj – Cili nen?

Anastas Angjeli – Ishte një nen i nismës ligjore të propozuar nga zoti Vullnet për rentën minerare dhe ne dolëm 5 me 5.

(Diskutime pa mikrofon)

Një minutë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Amendamentin do ta diskutosh me grupin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ju lutem!

Meqenëse sipas Rregullores nuk patëm vendimmarrje, sepse dolëm 5 me 5 dhe ju erdhët tani, ju ftoj ta rivotojmë edhe një herë për të pasur një vendimmarrje të qartë dhe për të mos qenë barazim.

Arben Ahmetaj – Atëherë ...

Anastas Angjeli – Kush është dakord me amendamentin e Vullnet? Kush nuk është dakord?

Arben Ahmetaj – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ai është pjesë e grupit tim parlamentar. Si e shpërbëj unë sistemin fiskal? Për çfarë jam unë këtu?

Kush është pro amendamentit të zotit Vullnet Sinaj? 4 pro. Kush është kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju kuptova.

5 pro.

(Diskutime pa mikrofon)

6 pro.

Atëherë, nuk ka vendimmarrje. Do t'ia kërkojmë vendimmarrjen seancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E votove në tërësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë amendamenti i zotit Vullnet nuk kaloi për t'u futur në projektligj, do të votojmë projektligjin në tërësi pa amendamentin e zotit Vullnet dhe do t'i kërkojmë seancës t'i referohet amendamentit të zotit Vullnet.

Zoti Vullnet propozoi që e gjithë taksa, e gjithë renta t'i ...

(Diskutime pa mikrofon)

Në ç'kuptim e ke bërë 10 nga 5?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke ndonjë burim tjetër për burimin që humb qeveria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova.

Doli 6 me 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ia kërkojmë seancës. Deputeti ka të drejtë të bëjë amendamentin e vetë.
Do të votojmë projektligjin pa amendamentin, sepse nuk hyri në fuqi dhe as nuk u rrëzua.

Kush është pro në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 16.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”

4. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Reme Lala, Eljo Hysko.

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomise

11. Zv/Minister Z. Elton Haxhi,
12. Z. Niko Lera, Drejtor I Pergjithshem,
13. Z. Enkeleda Pipa, Drejtor I Politikave Fisdkafe
14. Z. Enkeleda Kuci, Pergjegjes Sektori Politikave
15. Z. Doriane Toro, Specialist

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

7. Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtoreshe e Pergjithshme,
8. Znj. Ilda Koja, Drejtor Juridik
9. Z. Klodi Plloca, Drejtr IT

(Mungesë incizimi)

Arben Ahmetaj - Kalojmë në projektligjin tjetër.

Anastas Angjeli – Para se të diskutojmë nenin 1, ka dy propozime, një nga zoti Roshi dhe një nga zoti Vullnet.

Zoti Roshi, fjala për ju.

Artur Roshi – Faleminderit!

Shkronja “p” e nenit 1 të projektligjit të ndryshohet si më poshtë:

Pas fjalëve “furnizimi i automjeteve vetëm me motor elektrik” të shtohen fjalët “...edhe me motor hibrid”. Çfarë do të thotë kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ndryshimin e këtij neni shtrihet lehtësia fiskale në një gamë më të gjerë të mjeteve që nuk ndotin mjedisin. Nëse kemi parashikuar motorët elektrikë si të tillë, nuk kemi pse të diferencojmë motorët hibridë, që kanë të njëjtin efekt ndaj mjedisit, atë miqësor dhe të mosndotjes. Për këtë arsye propozoj që edhe këta motorë të përfitojnë lehtësira fiskale në kuptimin e këtij ligji.

Për ta shtuar, mund të mos jetë në masën e motorëve elektrikë, por të jetë në masën 30% të TVSH-së.

Arben Ahmetaj – Cili është mendimi i ministrisë për propozimin e zotit Roshi?

Elton Haxhi – Motori hibrid punon edhe me bateri, edhe me karburant.

Arben Ahmetaj – Jeni pro apo kundër?

Elton Haxhi – Po.

Arben Ahmetaj – Hedhim në votim ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti e bërë propozimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Punon me benzinë dhe me bateri. Unë nuk ju thashë 100% si motorët elektrikë, që janë 100% me bateri, por 20%-30%, që do të thotë 1/3. Cila është logjika e ndarjes së kësaj? Pjesa e benzinës ndot ...

Ne supozojmë se 1/3 është një taksë fiktive e shtetit, që merret në çdo rast dhe 1/3 është pjesë e baterisë. Pjesa e baterisë, edhe kur është elektrike... Nuk ka logjikë të thuash ... Po, është me dy standarde, zoti zëvendësministër, kështu që duhet parë në një logjikë proporcionale.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni të drejtoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e dëgjova dhe tha “jo”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dëgjova.

Ma kanë bërë këtë propozim vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, unë e dëgjova,

Ti the: “bateria” dhe “30%”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush nuk dëgjoi? E shikon që kam dëgjuar? Si ka mundësi që nuk kam dëgjuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Ministria u shpreh ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është ky diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, ju u shprehët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bazë të procedurës ju u shprehët dhe bëtë edhe amendamentin , i cili do të hidhet në votë. Ministria është shprehur kundër. Kush ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ta kam dhënë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mjaft, sepse do të ndjekim procedurën parlamentare! Mos u bëni qesharakë!

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju nxjerr jashtë dhe do të lini nam!

Do të jeni të dytët në Republikën e Shqipërisë, sepse ka nxjerrë dikush njëren më parë jashtë sallës.

Kush është pro amendamentit të zotit Roshi? 4 pro. Kundër? 7 kundër.

Bie amendamenti i zotit Roshi.

Unë kam një koment.

Ministria ka sjellë logjikën e motorëve elektrikë për automjetete me zero, ndërkohë që keni lënë ...

(Diskutime pa mikrofon)

Artur Roshi - Ju bëni një ligj të personalizuar për një njeri që e ka emrin X, por bini ndesh me atë që tha zoti Angjeli, që nuk duhet të bëjmë ligje të personalizuar. Jam dakord, por tani jemi me një ligj të personalizuar. Për një njeri që bën importin e autobusëve elektrikë, ne bëjmë ligj për autobusët elektrikë.

Qeveria është klienteliste.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, më ndërpreve.

Unë propozoj që, meqenëse furnizimi i automjeteve vetëm me motor elektrik, të reja, me zero kilometër, që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, përveç atyre të përcaktuar në pikën 7 të nenit 49 të ligjit... Çfarë bën ministria? E keni logjikë të papranueshme fiskale. Ju sillni automjetet private elektrike me zero kilometër dhe nuk sillni autobusët për transportit elektrik. Çdo të thotë kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë 6%. Mos e shikoni ashtu!

Autobusët elektrikë duhet të bëhen patjetër ...

Si mund të bëhen automjetet private me zero dhe autobusët me ...

Pra, propozimi im është që autobusët të ...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko, Turi, ju lutem, pushoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni, të mbarojmë!

A mund të ndjekim procedurën?

Ky është komisioni më i mirë dhe e humbet disiplinën rrugës. Pra, propozimi im është që edhe autobusët, me të njëjtën logjikë, të jenë të rinj, të peregjistruar në asnjë shtet tjetër, me zero kilometër, me motorë elektrikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni me përjashtim këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëj propozimin. E keni me zero apo me përjashtim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni me përjashtim.

Atëherë, me të njëjtën logjikë të shtohen edhe autobusët, që nuk janë regjistruar në asnjë shtet tjetër, të jenë të rinj, me zero kilometër.

Kush është dakord që ky propozim t'i shtohet nenit 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë incizimi)....do të vazhdojnë të trajtohen me të njëjtin regjim fiskal.

Kush është dakord me propozimin që autobusët për transport publik me motorë elektrikë me zero kilometër, që nuk janë regjistruar në asnjë shtet tjetër më parë, të jenë me TVSH të përjashtuar?

Ju mos e ngrini dorën, sepse nuk jeni administratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 49, që është me 6%, duhet hequr.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Lera – E caktuam 6% TVSH deri në 21-in dhe 10% pas **21-it** për autobusët e transportit publik. TVSH-në që ata do të paguajnë me tarifa të reduktuara e kreditojnë menjëherë nga TVSH-ja e ...

Arben Ahmetaj – Atëherë do e bëjmë zero. Dakord.

Faleminderit!

Niko Lera – Nuk është eksport që se bën dot zero.

Arben Ahmetaj – Më fal! Si ka mundësi që ju vini dhe sillni këtu përjashtim për automjetet private dhe për autobusët?

Niko Lera – Sepse automjetet private do t'i importojnë individët dhe individët nuk kanë çfarë të kreditojnë.

Arben Ahmetaj – Dakord, do ia bëjmë zero.

Faleminderit që më korrigjove propozimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si the?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush tha që nuk kemi? Ja po e bëjmë tani. Kemi TVSH zero.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shikon që kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë, pastaj? A kemi nivel zero? Kemi nivel zero në eksport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë, pastaj? Zero. Meqë ti nuk do që ata ta kenë të përjashtuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të përjashtuar, jo me zero.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me propozimin tim që autobusët ta kenë zero?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse pyet dy herë? Unë thashë zero.

Niko, rakordohuni me Ervinin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si nuk ka si të shkruhet?

Anastas Angjeli – Siç shkruam të tjerat, do të shkruajmë edhe këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk ka rëndësi. Ka shkallë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është logjikë, jo lojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, do ta votojmë siç është, pa shtesën për autobusët dhe do të bëjmë një diskutim. Nëse në seancë do të kemi një propozim, do ta gjykojmë në seancë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Zoti Vullnet, lexoni amendamentin tuaj për nenin 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, keni vëmendjen se mbaruam!

Vullnet Sinaj - Propozoj që në ligjin 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të bëhen dy ndryshime.

E para, para nenit 1 të projektligjit të shtohet një nen i ri me qëllim shtimin e një pike të re pas pikës 8 të nenit 49, të ligjit bazë, që ka të bëjë me TVSH-në e reduktuar, me këtë përmbajtje: “9. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mallrave nga personat e tatueshëm, të cilët zbatojnë skemën e kompensimit të **prodhuesve bujqësorë** sipas seksionit 4 të këtij ligji, është 10%”.

Arben Ahmetaj – Më fal! E ke për nenin 8 apo për nenin 1?

Vullnet Sinaj – Para nenit 1.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Vullnet Sinaj – Pika 1, që unë dua të shtoj, ka të bëjë me ...

Arben Ahmetaj – Pra, e ke fjalën që nga 6 të shkojë në 10?

Vullnet Sinaj – Jo, të shtohet, të bëhet 10 për produktet bujqësore. Është shtesë.

Arben Ahmetaj – Pra, nga 6 në 10?

Vullnet Sinaj – Jo nga 6.

Arben Ahmetaj – Më fal, na e sqaro edhe një herë.

Vullnet Sinaj – Te ligji bazë, neni 49 përfundon me pikën 8. Unë propozoj që pas pikës 8 të shtohet pika 9 ku të thuhet: “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mallrave nga personat e tatueshëm, të cilët zbatojnë skemën e kompensimit të **prodhuesve bujqësorë**, sipas seksionit 4 të këtij ligji, është 10%”. Kjo ka lidhje me ndryshimin tjetër që propozohet më pas, që, po të më lejoni ju, mund t’jua them tani.

Arben Ahmetaj –Ju lutem, thuajeni!

Vullnet Sinaj – Propozimi i dytë është që pas nenit 14 të projektligjit të shtohet neni 14/1, që ndryshon nenin 148 të ligjit bazë, me këtë përmbajtje: “shprehja “6%” të zëvendësohet me shprehjen “10%”. Unë propozoj që TVSH-ja të jetë 10% në të dyja rastet, edhe në grumbullimin e produkteve bujqësore, edhe në shitjen e tyre. Do më lini të arsyetoj?

Arben Ahmetaj – Nuk ka nevojë, sepse e kemi diskutuar.

Vullnet Sinaj – Ta shpjegoj që të bindeni.

Arben Ahmetaj – Nuk është e nevojshme, sepse ne e kemi diskutuar disa herë. Çfarë mendimi ka ministria për propozimin tuaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Kushi, ju lutem!

Evis Kushi - Për procedurë, unë kam një sugjerim për komisionin, për këshilltarët, që, çdo herë, kur vijnë amendamente nga deputetët, në momentin që dorëzohen në komision, i lutem komisionit të na i vendos në dispozicion që ne të kemi kohë të mendohemi, të reflektojmë, që të mos përballemi në ...

Arben Ahmetaj – Shumë e saktë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, sepse do ta mbyll mbledhjen e komisionit pas 5 minutash.

Bëjeni vetë atë.

Çfarë mendimi keni për amendamentin e zotit Vullnet?

Niko Lera – Zoti Sinaj propozon që të reduktohet shkalla e TVSH-së për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale nga 20%, që është aktualisht, në 10% dhe njëkohësisht të rritet edhe norma e grumbullimit dhe kompensimit ...

Arben Ahmetaj – E dimë çfarë propozon, por po ju pyes çfarë mendimi keni ju si ministri.

Niko Lera – Për momentin nuk jemi në gjendje ta llogarisim, por ne mendojmë që kjo ka një kosto shumë të madhe në buxhetin e shtetit në kuptimin e reduktimit të të ardhurave nga TVSH-ja. Sepse normën e reduktuar do ta përdorësh si për mallrat e prodhuar në vend, ashtu edhe për importet. Për çdo mall ushqimor importi që t'i e jep, do të përdorësh ...

Arben Ahmetaj – Faleminderit! E kuptova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, Vullnet! Patjetër.

Keni për detyrë ta studioni këtë propozim. Gjithsesi, për procedurë ne do ta hedhim në votim, kurse ju duhet të na sillni një informacion çfarë efekti do të kishte në të ardhura.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë doni tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ke çfarë të mbrosh, sepse bërë amendamentin për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aman, o zonjë, po si nuk pushove, o motra ime!?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po unë drejtoj mbledhjen. Hajde drejtoje ti dhe jemi në rregull. Unë e kam për detyrë që të mos pushojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe u lodha, sepse ti nuk pushon.

Vullnet, ju bëtë amendamentin, propozim tuaj, i cili do të hidhet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Vullnet Sinaj – Shumë faleminderit, kryetar, për mundësinë që më dhatë!

Nuk po zgjatem në efektet që ka dhënë në ekonomi kjo gjë, por dua të them që TVSH-ja është një formulë dhe duhet ta ketë vlerën të barabartë si në blerje, ashtu edhe në shitje, në mënyrë që të na japë tatimin mbi vlerën e shtuar të produktit që shitet. Në momentin që këto të dyja nuk barazohen, ajo nuk është më formulë dhe nuk na jep më tatimin mbi vlerën e shtuar. Korrigjojmë një gabim shkencor dhe matematikor në formulë, e cila ka dhënë pasoja në ekonominë shqiptare, që po të më lejoni jua them të gjitha. Është formulë që nuk duhet të ndryshojë si në blerje, ashtu edhe në shitje. Është përdorur në Francë në vitin '54 dhe nuk kam gjetur një rast të dytë në të gjithë botën për këtë gjë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Çfarë kishe?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, çfarë kishe?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Boll, se nuk të kam dhenë leje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po bëhemi qesharakë.

Deputeti ka bërë një propozim që duhet diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka shumë praktika të kësaj natyre, jo vetëm në Francë, në shumë vende të botës, të cilat do jua vë në dispozicion, zoti Vullnet. Megjithatë, ky diskutim është bërë edhe vitin e kaluar po në këtë komision dhe unë kam ngulur këmbë për jo. Më thatë që do të dëmtohet bujqësia, eksporti, por të dyja rezultuan me rritje. Bujqësia u rrit 2%, si rrallëherë, në një kohë që mezi shkonte 1,2%, kurse eksporti është 14,3% i produkteve bujqësore. Do të thotë që argumenti juaj numerik, në këndvështrimin tim, duke e respektuar mendimin tuaj, nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk do të bëjmë debat bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të bëjmë debat. Ka procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thatë mendimin tuaj, unë timin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, 2%-i është shifër, 14,3%-i është shifër në eksport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, zoti Vullnet. Do të hedhim në votim propozimin tuaj. Hedhim në votim propozimin e zotit Vullnet Sinaj, i cili kërkon uljen e TVSH-së së produkteve bujqësore në shitje nga 20% në 10% dhe rritjen e kompensimit nga 6% në 10%.

Pro? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, e drejtoj unë mbledhjen!

Kush është kundër? 7 vota kundër, 5 vota pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

8 me 4. Rrëzohet propozimi i zotit Sinaj.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Pas nenit 1 dhe propozimeve të bëra nga tre amendamentet, të cilat siç e patë nuk u miratuan, neni 1 miratohet siç është.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në nenin 2 fjalët “fjalinë e fundit” ndryshohen me “paragrafin e fundit”.

Kush është dakord me ndryshimin e nenit 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Neni 3. Edhe në nenin 3, ashtu siç kemi thënë që në fillim të mbledhjeve për paketën fiskale, reflektohet ligji i parë, që miratuam paradite, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Prandaj, për teknikë legjislative, ky duhet të zëvendësohet gjithmonë me fjalët “legjislacioni në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit dhe të qarkullimit”. Ka pyetje?

Kush është dakord me ndryshimin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Neni 4.

Arben Ahmetaj – Më fal! Zoti Angjeli, mund të bëj një ndërhyrje këtu? Unë dua që, me dakordësinë e qeverisë, të bëj një propozim për ...

Anastas Angjeli – Jemi te neni 3.

Arben Ahmetaj – Ta gjykojmë, sepse ndoshta mund të jetë edhe nen i ri. Besoj se duhet ta ndjekim këtë logjikë. Unë dua që të bëj ndryshime ...

Zoti Niko, zonja drejtoreshë, Enkelejda, zoti zëvendësministër, më ndiqni, sepse janë të rëndësishme dhe do të prekin një program qeveritar. Qëllimi im është që të ofrojmë përjashtim nga TVSH-ja për mallra, të cilat do të përdoren në rindërtimin e dëmeve nga tërmeti, të kufizuara vetëm në programin e rindërtimit që kemi kaluar në buxhet në parim dhe që do ta detajojmë nesër për ta votuar në datën 18. Pra, po kërkoj të përjashtohen në import dhe në ndërtim të gjitha ato objekte banesa, që do të bëhen nga qeveria në potencë apo edhe donatorët

(do të ndërtojë Turqia dhe ndoshta edhe Katari). Të përjashtohen në import shtëpitë në total, sepse mund të ketë importim të shtëpive si blloqe, hekuri, çimentoja, një listë e kufizuar me materialet e ndërtimit dhe ndërtimi brenda vendit vetëm për programin e rindërtimit, e kufizuar dhe me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ato kompani që do të fitojnë thirrjet nga qeveria apo do të autorizohen nga ju nëpërmjet koordinimit që do të bëj qeveria me shtetet që do të ndërtojnë dhe dhurojnë shtëpi apo fondacione që do të ndërtojnë shtëpi.

Pra, vetëm për programin e rindërtimit të pezullojmë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turi, të lutem! Prandaj thashë me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që e kontrollon. E para, do të çoj kërkesën nga donatori, e dyta, do të sjellë lejen e ndërtimit, e treta, do të sjellë lejen e ...

Për një ndërtim dhe për aq kufizohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'i rrisë volumet, por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku do ta bëjë një ndërtesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flasim vetëm për programin e rindërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ama o Turi, çfarë e ke këtë pyetje?

Evis Kushi – Ju lutem për procedurë!

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ka për procedurë, sepse po bëj një propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, fol me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Evis Kushi – Unë kam një propozim. Meqenëse këto janë projektligje shumë të rëndësishme dhe unë shikoj që rendimenti i mbledhjes po bie, a mund ta vazhdojmë nesër mbledhjen e komisionit, sepse ne do të vijmë edhe nesër? Nuk kemi pse t'i votojmë me nxitim. Si mendoni?

Arben Ahmetaj – Jam dakord me ju. Më shkruani propozimin në mënyrë teknike, të detajuar, që të kufizojë evazionin dhe të ndihmojë rindërtimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jam dakord me zonjën Kushi. Do ta mbyllim mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ta mbaroj unë mendimin, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë punë kam unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk jua ndërpres kurrë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di sa herë ke folur?

Niko, zonja drejtoreshë, zoti zëvendësministër, Enkelejda, ma shkruani këtë që thashë nesër, së bashku me Ervinën, dhe ta paraqesim si amendament të shkruar.

Faleminderit! Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Nesër do të mblidhemi në orën 11:00, ku do të diskutojmë të gjithë paketën fiskale dhe buxhetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, nesër nuk do ikim. Do të hani drekë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti